

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7337 E diel 29 Tetor 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion **Ditës**
Ajo që ndodhi pardje, më 26 tetor në Barcelonë, kryeqyteti i rajonit autonom të Katalonjës në Spanjë i ngjante shumë shpalljes së pavarësisë ...
Vijon në faqen 21

Nga JORGJI KOTE
Katalonja spanjolle si Flandra Belge

Dje në "Deutsche Welle"
Grindja e gjatë dhe e vështirë për statusin e Katalonjës është acaruar javët e fundit. Stanislav Strasburger është i bindur se kultura dhe identiteti janë çështje ...
Vijon në faqen 22

Nga STANISLAV STRASBURGER
Evropa ime: Corrida, Katalonja dhe pavarësia



Misteri i makinës që shiti Saimir Tahiri
"Audi" i Habilajve lëvizi në Greqi, 2 vëllezërit i kanë ndryshuar targat

Gazetari Basir Çollaku: S'është e vërtetë që Dritan Zagani u dënua nga Krimet e Rënda
Makina e ish-ministrit Tahiri, 'shitur' Habilajve ndërrohet targë, por përdorues jo, ata janë sërish Artan dhe Moisi Habilaj. Janë pikërisht vëllezërit Habilaj, të cilët kanë bërë pagesat, kur kanë paguar siguracionin e mjeditit". Gazetari Basir Çollaku, i cili ka realizuar së fundmi dy intervistat që kanë tronditur ...
Në faqen 2

NDERTIMET PA LEJE/ REGJISTRIMI NE PORTALIN "E-ALBANIA", BRENDIA 10 DITEVE

LEGALIZIMET, PROCEDURA E RE PER TE MARRE TAPINE

Dokumentet që duhen për ta regjistruar pronën në Hipotekë në mënyrë elektronike, pa pritur dosjen nga ALUIZNI. Kostoja e aplikimit, 5 mijë lekë



(Në foto) Ndertime pa leje në Tiranë

DOSJA "DROGA"
Basha: Rama dhe Tahiri në panik, do publikohen fakte të reja
Në faqen 3

"MASAKRA E LUSHNJES"
I ati i Laert Haxhiut: Nëse im bir ka vrrarë, do ta var në litar
Në faqen 8

LISTA EMERORE
Ndertimet pa leje, 2 mijë familjet që kanë gati legalizimin
Në faqen 9-11

LETESI
Açka: Thertorja ku punova, si Shqipëria në diktaturë
Në faqen 12

MOSKO Shkrepja e titulluar "Macja e zeze" e Petrit Kunit fitoi "World Press Photo"

"17 Nëntori - Besa", fotoja me 'medalje nderi' në Moskë

Në brendësi: Poezia e Agollit nga Shpëtim Çuçka. "Nostalgjikët" nga Ben Andoni

Nga QERIM VRIONI
Fotografia e sportit, përgjithësisht përbën një degë të fotogazetarisë. Historikisht në botë, "fotografia e sportit ka bërë një rrugë të gjatë qysh prej analizave të hershme të Muybridge me vrapimet e kuajve"(Ang

Tom-Photography-The definitive visual history-DK, New York, 2014, f.356). Fotografia e parë shqiptare me këtë temë (me të dhënat e deritanishme) daton tetorin e vitit 1913. Në foto paraqiten në fushën e lojës dy skuadra futbolli, ajo e ushtrisë Austro-hungareze (të



dislokuar në veri të vendit) dhe skuadrës së Shkodrës, "Indipendencia" të rreshtuara para një ndeshje midis tyre. Autori i fotos mbahet mjeshtri aparatit, Kel Marubi (Marubi-Njerëz në Za e sende të kujdesshme-Fototeka Kombëtare Marubi, Shkodër, ...
Suplement

ÇESHTJA "TAHIRI" REAGIMET

Deklarata e Ramës për Dritan Zaganin, gazetari: Kryeministri gënjeu live

Basir Çollaku: Targa e re e 'Audi'-t të ish-ministrit Tahiri është AA900 NF

"Mjeti është sërish i Habilajve, polica e sigurimit u pre në Korçë, me shumë gjasë për udhëtim jashtë vendit"

TIRANË


Makina e ish-ministrit Tahiri, 'shitur' Habilajve ndërron targë, por përdorues jo, ata janë sërish Artan dhe Moisi Habilaj. Janë pikërisht vëllezërit Habilaj, të cilët kanë bërë pagesat, kur kanë paguar siguracionin e mjetit". Gazetari Basir Çollaku, i cili ka realizuar së fundmi dy intervistat që kanë tronditur qeverinë, atë me ish-shefin e Antidrogës së Fierit, Dritan Zaganin dhe ish-officerin e Antidrogës, Antonio Nazera (të dy ish-policët janë burgosur dhe kërcënuar për t'u vrrarë, ndërsa sot janë në azil politik), dhe ka zbuluar targën e re të automjetit tip "Audi", të ish-ministrit të Brendshëm. Në një postim në rrjetin social "Facebook", Çollaku ka treguar se çila është targa e re e "Audi"-t A8. Sipas tij, ajo është AA900NF. Mes të tjerash, Çollaku thekson se pronarët janë sërish Habilajt, Artan e Moisi Habilaj. Reagimi i gazetarit erdhi një ditë pas lajmit që qarkulloi në media se targa e mjetit të shumëpërfolur 'Audi' AA 003 GB e që dyshohet se përdorej nga grupi 'Habilaj' për transport droge, u regjistrua nga Drejtoria e Transportit Krugor nga sistemi i targave. Gjithashtu, gazetari Basir Çollaku ka reguar edhe në lidhje me deklaratat që kryeministri Edi Rama bëri mbrëmjen e së premtes në emisionin "Zonë e Lirë" mbi pretendimin se Gjykata për Krimet e Rënda ka dënuar për "dekonspirim" ish-krerun e Antidrogës në Fier, Dritan Zaganin. Në një mesazh në 'FB', ai ka hedhur poshtë deklaratën e Ramës, ndërsa akuzoi këtë të fundit se gënjente. Mes të tjerash, Çollaku e cilëson qëndrimin e Ramës një tjetër shpifje të reagimit ndaj Zaganit.

REAGIMI I ÇOLLAKUT PËR "AUDI"-N E HABILAJVE


AA003GB është bërë AA900 NF sërish Habilaj... dhe sërish udhëtime jashtë



Gazetari Basir Çollaku



Faksimile e policës së sigurimit



DEKLARATA E RAMËS NË "ZONË E LIRË"

"E di ku ka përfunduar, por në Republikën e Shqipërisë ai është dënuar nga Gjykata e Krimeve të Rënda. Me këto farë gjykatash, ose je i pandehur politik, ose kaq shumë provohet fajësia jote, sa nuk bëjmë dot një pazar për të liruar. Kështu që, kur e ka dënuar Gjykata e Krimeve të Rënda dhe prokuroria e ka çuar për shpërdorim detyre dhe nuk e di se çfarë tjetër, çfarë duhet verifikuar më shumë?! Ajo prokurori dhe ajo gjykatë nuk kanë pasur asnjë arsye në botë që të lëvizin një gisht për hatër të Saimir Tahirit".

vendit. Makina e ish-ministrit Tahiri, "shitur" Habilajve ndërron targë, por përdorues jo, ata janë sërish Artan dhe Moisi Habilaj. Janë pikërisht vëllezërit Habilaj, të cilët kanë bërë pagesat kur kanë paguar siguracionin e mjetit. Policën e sigurimit që ka në fuqi mjeti e ka pre-

rë më 4 korrik. Ndërkohë, në qershor të këtij viti përdoruesit e 'Audi'-t AA900NF (AA003GB) kanë prerë në Korçë një policë sigurimi karton jeshil, me shumë gjasë për udhëtim jashtë vendit dhe më afër prejresë policës është për në Greqi për periudhën 1 deri më

15 qershor. Ndërkohë, mjeti tashmë AA900NF (AA003GB) sipas shkresave ka numër shasie WAUZZZ4E79N005250, duke dëshmuar se ndryshon sipërfaqja, jo brendia. Ndoshta prokuroria do të mundësojë verifikime më konkrete. Natyrisht, nëse



Makina e ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri



Hetimi ndaj vëllezërve

Habilaj, prokurorët shqiptarë në Katania

TIRANË - Një grup hetuesish dhe prokurorësh që hetojnë dosjen "Habilaj" në Shqipëri si dhe ndaj ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri, pritet të mbërrijnë në Katania për të parë nga afer hetimet mbi këtë rast. Lajmi konfirmohet për televizionin "Klan" nga burime të Prokurorisë së Krimeve të Rënda, të cilat thanë se hetuesit pritet të mbërrijnë në Katania gjatë javës që vjen. Nuk dihet nëse vetë hetuesit mund të kryejnë veprime konkrete me autorizim të palës italiane, apo se vetëm do të kërkojnë të njihen më në detaje me materialet e dosjes në fjalë.

nuk vazhdon të kërkojë targën e vjetër... (për ata që s'besojnë...).

REAGIMI I ÇOLLAKUT PËR DEKLARATËN E RAMËS

Rama, i lirë të gënjejë live në "Zonë e Lirë" për Zaganin. Kryeministri Edi Rama gënjen live. Dritan Zaganin nuk është dënuar nga Gjykata për Krime të Rënda. Çështja është ende në gjykim në Gjykatën e Fierit dhe akuzat nuk është ajo që tha z. KM. Oficeri italian do të dëshmojë në fund të vitit, siç ka vendosur Gjykata e Romës. Shpifja tjetër e Ramës, për akuzë bashkëpunimi me trafi-

kantët. Prokuroria nuk i ka hetuar akuzat e Zaganit. Ka qenë një relativitet i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë për të verifikuar pretendimet e shefit të Antidrogës. Dhe kjo, në mënyrë të çuditshme nga Prokuroria e Fierit, ndonëse pretendimet për trafik droge duhet të hetohen nga Krimet e Rënda. Një turp live i gënjeshtërsë së KMRama.



Valentina Madani

Kreu i opozitës, Lulzim Basha, paralajmëroi dje se javën që vjen do të dalin në dritë të dhëna të reja, që sipas tij e lidhin qeverinë "Rama" me krimin e organizuar. Z.Basha njoftoi përmes një konference për shtyp zbardhjen e fakteve të reja, të cilat siç tha ai, zbulojnë se anëtarë të qeverisë aktuale dhe kryeministri Edi Rama janë të përfshirë në mbështetjen kriminale dhe drogës. Basha nuk dha detaje nëse ato lidhen me dosjen "Habilaj", duke theksuar se publikimi i tyre është çështje ditësh. "Rama e Tahiri sot janë në panik e dëshpërim se po ndeshen me të vërtetën dhe kanë humbur çdo kontroll të së vërtetës. Në ditët e ardhshme do të ketë të reja të tjera, që zbulojnë përfshirjen e qeveritarëve shqiptarë dhe të Ramës në mbështetje e mbrojtje të kriminit e trafikantëve të drogës. Edhe bota e ka kuptuar dhe nuk mund të lejojë më një shtet të kontrolluar nga krimi në mes të Europës", - theksoi z.Basha. I pyetur se për çfarë të reja bëhet fjalë, Basha shtoi: "Ne po shqyrtojmë çdo material që tregon lidhjet e kriminit me politikanët. Ua lëmë ditëve të ardhshme të publikohen të dhënat që disponohen. Opozita kërkon transparencë". Kreu i PD-së u shpreh për ndërgjegjësimit të ndërkombëtarëve, ndërsa shtoi se qëndrimi i tyre është i qartë: mbështetje për prokurorët e gjyqtarët që po hetojnë lidhjet e politikës shqiptare me krimin. "Dënim të sulmeve politike ndaj drejtësisë, barazi para ligjit e çdokujt, përfshirë edhe politikanët më të lartë". Gjithashtu, ai u shpreh se, "opozita është në kontakt të vazhdueshëm me qytetarët, oficerët e policisë dhe partnerët". Basha akuzoi Ramën se po bën avokatin mbrojtës të Saimir Tahirit dhe të vëllezërve Habilaj dhe kërkoi që personat të cilët arrestuan ish-punonjësin e policisë, Dritan Zaganin, të merren si të pandehur. "Dritan Zaganin nuk ka qenë kurrë i dënuar nga Krimet e Rëndë. Edi Rama gënjeu drejtëpërdrejt para miliona shqiptarëve. Tahiri e arrestoi Zaganin, sepse ai nuk heshti, por guxoi, ngriti zërin dhe hetoi lidhjet kriminale Tahiri-Habilaj. Sipas kodit mafioz të hakmarrjes kundër atij që flet, Edi Rama dhe Saimir Tahiri kërkuan ta bënin shembull Zaganin, për t'i treguar çdokujt se çfarë i pret nëse flasin. Por, akuzat qesharake të montuara nga Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm, një drejtori e Ministrisë së Brendshme nën urdhrat e Tahirit, nuk dhanë asnjë rezultat, megjithë presionin e madh që Rama dhe Tahiri ushtruan. Punonjësit e Shërbimit të Kontrollit të ministrisë që arrestuan Zaganin duhet të hetohen dhe të merren të pandehur për montim aku-

"Habilaj", kreu i PD: Qeveritarë të tjerë, të përfshirë me krimin

Basha: Rama e Tahiri në panik, së shpejti fakte të reja

"Të hetohet kush arrestoi Zaganin"



Kreu i PD-së, Lulzim Basha

POLICIA

"Dita e të rënëve të policisë në krye të detyrës na kujton ata burra me uniformë, me kurajë e integritet, që dhanë jetën në luftë kundër kriminit. Ne nuk mund ta lemë sakrificën e tyre të shkojë dëm. Krimi, bandat dhe mafia duhen shtypur, por kjo bëhet e mundur vetëm me një qeveri që nuk i mbron dhe ndan pushtetin me ta, por i lufton, i ndëshkon dhe i çon ata dhe pushtetarët e korruptuar, që sot janë mburoja e kriminit para drejtësisë", tha z.Basha.



Situata, Pack-Vlahutin: Thyej heshtjen

Europarlamentarja Doris Pack i kërkon ambasadores së BE-së në Tiranë që të thyejë heshtjen ndaj zhvillimeve të fundit në Shqipëri. Duke marrë shkas nga situata politike në vend, ku në fokus është çështja "Tahiri", vjen reagimi i fortë i ish-deputetes së Parlamentit Europian, Doris Pack, aktualisht presidente e Forumit të Grave të PPE. Në një postim të saj në "Twitter", Pack ndonëse nuk ka veçuar ndonjë çështje konkrete, pyet për faktin se pse nuk reagon ambasadorja e BE-së, Romana Vlahutin. Sipas Pack, në një kohë kur Shqipëria është vend kandidat për BE, kërkohet një drejtësi më të mirë, nëse gabime të dukshme nuk vihen në dukje. "Pse ambasadorja e BE në Shqipëri nuk reagon? Shqipëria është vend kandidat. Kredibiliteti i BE kërkon një drejtësi më të mirë, nëse gabime të dukshme nuk vihen në dukje", shkruan Pack në mesazhin e saj, adresuar politikës shqiptare si dhe ambasadores Vlahutin.

Berisha: Rama, frikë nga dosjet e kriminit e korrupsionit

Ish-kryeministri Sali Berisha ka reaguar ndaj qënndrimin të kreu të qeverisë, Edi Rama, pas deklaratave të ambasadorit Donald Lu dhe zyrtarit të lartë amerikan, Hoyt Yee. Z.Berisha foli për dosjet, ku sipas tij, Rama është në panik se nga çasti në çast do t'i hapen. Për Berishën, "deklarata e zotit Hoyt Yee pas asaj të prokurorëve dhe Viktor Pontas, i cili nuk kishte asnjë të qindtën e aferave të mëdha të tij, e kanë çekuilibruar Ramën si asnjëherë më parë dhe përfundimisht. I disekuilibruar dhe absurd, Noriega beson se duke pasur Xhorxh Sorosin për avokat, do mund të shesë dosjet e drogës, vjedhjeve të qindra miliona eurove, si dosjet të agjitacionit dhe propagandës apo sabotazhit të regjimit komunist. Por, Rama e ndjen se vërtet ai bilokoi, në një vendim të pa precedent, drejtësinë për Saimir Tahirin. Vërtet lidhjet e tij me Xhorxh Sorosin janë më të fuqishme se sa mund të mendohen, por ai nuk do mund të bilokojë tik-takun e tmerrshëm të orës së drejtësisë që po afrohet. Kjo orë po pret revolucionin popullor, revoltën qytetare që do të përmbyset në Shqipëri marto-shtetin e Noriegës dhe vendos shpejt në këtë vend parimet e larta të drejtësisë dhe shtetit ligjor", deklaroi z.Berisha.



zash dhe konspiracion në mbështetje të kriminit. Këtë duhet të bënte Edi Rama, të çonte këta punonjës në prokurori. Por, Edi Rama nuk është më kryeministër, tani ai është avokati mbrojtës i Tahirit dhe i Habilajve. Siç e shikoni, ai merret vetëm me mbrojtjen e kriminit dhe me asgjë tjetër. Bredh studio më studio, podium më podium e në çdo vend duke bërë avokatin mbrojtës të Tahirit, sepse kështu mbron veten

Deputetët e PD-së: Edi Rama urdhërohet nga klanet mafioze

Një përfaqësi e PD-së, e kryesuar nga deputetët Edmond Spaho, Albana Vokshi dhe drejtuesi i Departamentit të Mjedisit, Jamarbër Mallezi morën pjesë në takim me banorët dhe aktivistë të shoqërisë civile, të cilët kundërshtojnë ndërtimin e landfillit të mbetjeve në Lekaj-Gosë në Bashkinë Krogogzhinë. Z.Spaho deklaroi se Bashkia e Krogogzhinës nuk ka respektuar asnjë kriter ligjor për ndërtimin e landfillit dhe se kryetari i saj refuzon të bëjë transparencën e këtij vendimi korruptiv. Deputetja Albana Vokshi deklaroi se pas këtij krimi mjedisor qëndron kryeministri, si përfaqësues i mafies në qeveri. Vokshi u bëri thirrje grave dhe vajzave të mos lejojnë ndërtimin e landfillit, që rrezikon të sjellë mbetjet e rrezikshme toksike në dyert e shtëpive. "Protestoni që të ndalet projekti kriminal që ju dhe fëmijët tuaj të jetoni jetën që meritoni", tha Vokshi. Përfaqësuesit e PD-së deklaruan se ndërtimi i landfillit po bëhet pa konsultim me banorët dhe se nuk ekziston asnjë projekt-dokument. Ata thanë se Bashkia e Krogogzhinës ka ndryshuar disa herë vendin e ndërtimit të landfillit, duke shtuar dyshimet për një veprë kriminale mjedisore të urdhëruar nga klanet të lidhura me mafien e mbetjeve.



hetojnë lidhjet e politikës me krimin, dënim të sulmeve dhe ndikimeve politike ndaj drejtësisë, barazi para ligjit ndaj çdokujt, përfshi edhe politikanët më të lartë", deklaroi kreu i PD-së, Lulzim Basha.

EPSA SHOQËRIA PËRMBARUESE PRIVATE "E.P.S.A"
 SHPK NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT PER :
 "Aparament" me sip. 237,15 m², Nr. Pas. 4/208+1-31, Vol.30, Fq.147, ZK 8514, e ndodhur ne Dures. Kjo pasuri eshte e hipotekuar ne favor te Banka Intesa SanPaolo Shqiperi sha. Çmimi me te cilin fillon ankandi eshte 71.719 Euro. Ankandi do te zhvillohet date 16.11.2017 ora 16.00 ne adresen Rr."L. Qemali", Pall."Fratari", K.6,Tirane.
 Per cdo informacion kontaktoni ne tel. 04 2262711 ose ne www.epsa.al

EPSA SHOQËRIA PËRMBARUESE PRIVATE "E.P.S.A"
 SHPK NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT PER :
 1- "Tuafl" me sip. 200 m² nga kjo ndretese 114 m² Nr. pasurie 9584, Vol. 27, Faqe 87, ZK 8532 i ndodhur ne Sheq i Madh, Fier. Pasuria eshte hipotekuar ne favor te Bankes Alpha sha. Çmimi me te cilin fillon ankandi i eshte 54.400 Euro. Ankandi per do te zhvillohet date 30.10.2017 ora 16.00 ne adresen Rr."L. Qemali", Pall."Fratari", K.6,Tirane .
 2- "Aro" me sip. 9.159 m² Nr. pasurie 11737, Vol. 10, Faqe 165, ZK 3981, i ndodhur ne Sheq i Fier. Pasuria eshte hipotekuar ne favor te Bankes Alpha sha. Çmimi me te cilin fillon ankandi i eshte 58.400 Euro. Ankandi per do te zhvillohet date 30.10.2017 ora 16.00 ne adresen Rr."L. Qemali", Pall."Fratari", K.6,Tirane .
 Per cdo informacion kontaktoni ne tel. 04 2262711 ose ne www.epsa.al.

REFORMA NE DREJTESI REAGIMET

Ish-presidenti: Sistemi i drejtësisë të mbrohet nga individët dhe kapja politike

'Tahiri', Nishani-Metës: Të zbardhet mbledhja e Këshillit të Sigurisë

"Reforma në Drejtësi e sfiduar, mbetet e rrezikuar"

Valentina Madani

Ish-Presidenti i Republikës, Bujar Nishani shprehu dje shqetësimin se reforma në drejtësi është e sfiduar, ndaj mbetet e rrezikuar. Ai foli për rëndësinë e ruajtjes dhe mbrojtjes së sistemit të drejtësisë nga kapja politike e mekanizmeve të reja dhe institucioneve të reja që do të krijohen dhe individëve, të cilëve do t'u besohet ky proces. Nisur nga kjo, Nishani i bëri dje thirrje presidentit aktual, Ilir Meta dhe medias që të zbardhin dhe të bëjnë publike mbledhjen e fundit të Këshillit të Sigurisë Kombëtare, që thirri për çështjen e kanabizimit të vendit. Në një intervistë të dhënë për "Channel One", Bujar Nishani nuk ka preferuar që të japë detaje për atë çfarë është thënë në atë mbledhje, por apeli i tij duket se ka lidhje me fakte, të cilat janë diskutuar në atë tryezë, pas shqetësimeve të ndërkomëtare për dosjen "Habibaj" dhe përfshirjen e mundshme të ish-ministrit Saimir Tahiri. "Unë do të ftoja të gjithë gazetarët që të kërkonin transkriptin e asaj mbledhjeje të Këshillit të Sigurisë Kombëtare dhe të perfrazonin qëndrimet nga Presidenti i Republikës dhe secili prej anëtarëve të Këshillit të Sigurisë Kombëtare, përfshirë edhe ministrit të Brendshëm të asaj kohe. Kjo, pasi besoj që për interesin publik mund të deklasifikohet, për momentin, pasi tani nuk ka më sekret shtetëror dhe shpresoj që administrata e Presidentit të Republikës ta deklasifikojë dhe të bëhet e ditur për opinionin publik", theksoi ish-presidenti Bujar Nishani. I pyetur se a është koha për rimbledhjen e Këshillit të Sigurisë Kombëtare, për kanabizimin të vendit, por edhe dyshimeve për lidhje të segmenteve politike dhe të policisë me krimin, për Nishanin është presidenti i vendit, ai që duhet ta vendosë një gjë të tillë. "Ajo është një çështje që i



Ish-Presidenti i Republikës, Bujar Nishani dhe ish-ministri Ssajmir Tahiri

takon Presidentit të Republikës, por situata në të cilën u mblodh Këshilli i Sigurisë ishte pikërisht shqetësimi që kishin institucionet ligjzbatuese të vendit, partnerët ndërkombëtarë dhe Presiden-

ti i Republikës", theksoi z.Nishani. Duke u ndalur tek reforma në drejtësi dhe mundësia e kapes së saj nga politika, me rastin e fundit kur mazhoranca votoi kundër kërkesës së prokurorisë

APELI
"Reforma në drejtësi është e sfiduar, ajo mbetet e rrezikuar. Uroj dhe shpresoj që të shoh vijimësinë e reformës në sistemin e drejtësisë, por sot më shumë se kurrë evidentohet fakti se e rëndësishme është ruajtja dhe mbrojtja nga kapja politike e mekanizmeve të reja dhe institucioneve të reja që do të krijohen dhe individëve, të cilëve do t'u besohet ky proces", tha z.Nishani.

për arrestimin e ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri, Nishani deklaroi se kryereforma mbetet e rrezikuar: "Reforma në drejtësi është e sfiduar, reforma në drejtësi mbetet e rrezikuar. Unë uroj



Gjatë një seance parlamentare

dhe shpresoj që të shoh vijimësinë e reformës në sistemin e drejtësisë, por sot më shumë sesa kurrë evidentohet fakti sesa e rëndësishme është ruajtja dhe mbrojtja nga kapja politike e mekanizmeve të reja dhe institucioneve të reja, që do të krijohen dhe individëve të cilëve do t'u besohet ky proces", tha ish-kreu i shtetit. Ish-presidenti Bujar Nishani mblodhi në Presidencë Këshillin e Sigurisë Kombëtare, mbledhje e kërkuar nga ish-kreu i Kuvendit, Ilir Meta në lidhje me mosarrestimin e Klement Balilit.



Bizneset e vogla ankohen tek deputetja Tabaku

Deputetja e PD-së, Jori Tabaku, takoi dje disa biznese të vogla në zonën e Medresesë në Tiranë, ku në fokus ishte kërkesa e qeverisë për të vendosur TVSH-në. Ata i shprehën shqetësimet lidhur me gjatësinë të vendosjes së TVSH, ndërsa Tabaku theksoi se një taksë e rëndë mbi ta do të thotë më shumë të papunë nesër: "Bizneset janë para dy zgjidhjesh ose do të rrisin çmimet, ose do të ulin fitimet në kufijtë e mbijetesës. Këto biznese kanë pasur kosto thelbësore dhe i rëndësishme. Për t'u bërë ballë krizave dhe sfidave të sigurisë me të cilat po përballlemi sot, procesi i integritit nuk duhet të frenohet apo ngadalësohet".

Kreu i Kuvendit, në sesionin për sfidën e krizave

Ruçi, thirrje BE-së: Procesi i ntegrimi të Ballkanit Perëndimor të mos frenohet



Kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi

është tepër thelbësor dhe i rëndësishëm. Për t'u bërë ballë krizave dhe sfidave të sigurisë me të cilat po përballlemi sot, procesi i integritit nuk duhet të frenohet apo ngadalësohet", tha Ruçi. Këto deklarata, kryeparlamentari i Shqipërisë i bëri gjatë punimeve të Konfer-

encës së 8-të të Kryetarëve të Paramenteve të vendeve të Ballkanit Perëndimor; ku në fokus të diskutimeve ishin sfidat me të cilat përballlemi sot rajoni ynë, por edhe gjithë globi. Ai theksoi se është i domosdoshëm bashkëpunimi intensiv për çështjet e mbrojtjes dhe sigurisë si brenda

INTEGRIMI
Vijimi dhe forcimi i 'Lidhjes transatlantike' dhe bashkëpunimit me SHBA-të është tepër thelbësor dhe i rëndësishëm. Për t'u bërë ballë krizave dhe sfidave të sigurisë me të cilat po përballlemi sot, procesi i integritit nuk duhet të frenohet apo ngadalësohet".

vendeve anëtare në kuadrin NATO-BE, por edhe me ato të Ballkanit Perëndimor. Ruçi ka theksuar se për t'u bërë ballë krizave dhe sfidave të sigurisë me të cilat po përballlemi sot, procesi i integritit nuk duhet të frenohet apo ngadalësohet.



Kryeministri Edi Rama zgjodhi dje Akademinë Politike të PS-së, për t'u kërkuar të rinjve të mos dekurajohen në ambicjet e tyre për të qenë pjesë e politikëbërjes. Kreu socialist u drejtua pikërisht brezit të politikaneve të rinj, që akademia promovon në kuadër të bashkëpunimit me fondacionin "Qemal Stafa", të drejtuar dikur nga Tahiri. Rama u tha të rinjve se është pikërisht politika, ajo që ashtu si mund të sjellë të këqija, mund edhe të bashkojë njerëzit e t'u japë atyre fuqi. Duke theksuar se kjo akademi e Partisë Socialiste është e para në vend, kryeministri i identifikoi si një prej instrumenteve më të rëndësishëm sa i përket prurjeve të reja në parti. "Politika nuk është punë e keqe, por mund të bëjë shumë keq kur nuk i

Kryeministri: PS, forcë që bën ndryshime

Rama, të rinjve: Mos u dekurajoni, politika jo e keqe



Kryeministri Edi Rama



"Politika nuk është punë e keqe, por mund të bëjë shumë keq kur nuk i bën punët mirë. Pa dyshim që në terrenin e sotëm ka shumë arsye për të qenë të demotivuar me ato që thuhet, dëgjohej e debatohet me mënyrën se si shpërdorohet fuqia e politikës për qëllime e agjenda të ndryshme".

bën punët mirë. Pa dyshim që në terrenin e sotëm ka shumë arsye për të qenë të demotivuar me ato që thuhet, dëgjohej e debatohet me mënyrën se si shpërdorohet fuqia e politikës për qëllime e agjenda të ndryshme, por nga ana tjetër, politika është i vetmi instru-

ment në dorën e njeriut për t'u bashkuar me të tjerë dhe për të bërë të mundur gjëra që janë të pamundura", tha z.Rama. Kryeministri u ndal edhe tek platforma 'online', që qeveria ka ndërmarrë në kuadër të bashkëqeverisjes me qytetarët, ku përsëriti thirrjen në adresë edhe të të

rinjve, që të denoncojnë çdo rast që përbën shkelje. "Kemi një hapësirë ku gjithkush ka vendin e vet dhe duket. Është një gjurmë që mbetet, nëse do të shkruani aty. Ky portal është një aplikacion për të pasur mikun më të madh në qeveri", tha z.Rama.

Kreu i LSI: Rama u zhvati 70 milionë euro qytetarëve, ua dha oligarkëve

Valentina Madani

Kryetarja e LSI, Monika Kryemadhi, i bëri dje thirrje kryeministrit Edi Rama që të dorëzojë ish-ministrin Tahiri dhe të lërë drejtësinë të bëjë punën e saj. Nga qyteti i Shkodrës, gjatë një takimi me strukturat e LSI, Kryemadhi deklaroi se Rama është kthyer në një lolo televizionesh, ndërsa gjendja e varfërisë dhe papunësisë në vend janë alarmante. Sipas saj, LSI është e vendosur ta demaskojë këtë kryeministër lolo dhe të gjithë zinxhirin kriminal. Më tej, Kryemadhi tha se qeveria mendon më shumë për oligarkët se për qytetarët dhe të rinjtë e papunë, duke shtuar se ajo u zhvati 70 milionë euro qytetarëve për t'ua dhënë oligarkëve. Kryemadhi akuzoi Ramën se censuroi në televizione aktivitetin që u mbajt të premtën në Tropojë, ku PD e LSI ishin bashkë për përrimin e statujës së Azem Hajdarit. "Rama është kthyer në një lolo televizionesh. Rama të dorëzojë lolon dhe të lërë drejtësinë të bëjë punën e saj. LSI është e vendosur të demaskojë këtë kryeministër lolo dhe të gjithë zinxhirin kriminal. Rama, një kryeministër në ikje i frikësuar. Nga frika, Rama censuroi në televizione aktivitetin madhështor për Azem Hajdarin. Gjendja e varfërisë dhe e papunësisë në Shqipëri është alarmante. Qindra-mijëra familje jetojnë me më pak se 2 dollarë në ditë, ndërsa mijëra të rinj kanë humbur shpresat për t'u punësuar në Shqipëri". Ndërsa akuzoi kryeministrin Rama se është në anën e oligarkëve, Kryemadhi tha se LSI nuk do të rreshtë së ofruari alternativat për zhvillimin dhe luftën kundër varfërisë, "ne jemi të vendosur në rrugën tonë". Po dje kryetarja e LSI-se reagoi sër-

Kryemadhi paralajmëron Ramën: Dorëzo Tahirin, do të të demaskojmë

"Lëre drejtësinë të bëjë punën e saj"



Kryetarja e LSI, Monika Kryemadhi

Ambasadorët

Dita europiane bëri dje bashkë 18 ambasadorë të vendeve të BE-së, të cilët zgjodhën të vizitonë Dibrën. Të kryesuar nga ambasadorja Romana Vlahutin, ambasadorët zhvilluan disa takime mes tyre edhe me kreun e bashkisë, Muharrem Rama.

ekonomike në Shqipëri është alarmante, se qindramijëra familje jetojnë me më pak se 2 dollarë në ditë, ndërsa mijëra të rinj kanë humbur shpresat për t'u punësuar në Shqipëri". Ndërsa akuzoi kryeministrin Rama se është në anën e oligarkëve, Kryemadhi tha se LSI nuk do të rreshtë së ofruari alternativat për zhvillimin dhe luftën kundër varfërisë, "ne jemi të vendosur në rrugën tonë". Po dje kryetarja e LSI-se reagoi sër-

ish ndaj kryeministrin Rama dhe deklaratave të tij mbrëmjen e djeshme në "Zonë e Lirë". Përmes një postimi në rrjetin social "Facebook", Kryemadhi shkruan se kjo ishte "përgatitje për premierën e shfaqjes së fundit", duke i thënë Ramës se "mbrëmë (të premtën) ishte në rolin e Lolos". Kujtojmë se "Lolo" ishte nofka e njeriut prej anëtarëve të bandës "Habibaj" e dalë në dosjen e përgjimeve të autoriteteve italiane. Kryemadhi thotë

se, "në përballjen finale për implikimet në zullumet e bandave të trafikut, nuk ua shkruan dot vetë pyetjet prokurorëve. Në përgatitje për premierën e shfaqjes së fundit, Edi Rama u shfaq mbrëmë në provën gjenerale

të rolit të Lolos. Me pyetje dhe përgjigje të gatuar në kuzhinat e oligarkëve, klientëve të tij besnikë, që të tillë kanë qenë pranë çdo kryeministri. Por, me sytë e errur nga frika e provave që e implikojnë edhe atë në zullumet e ban-

dave të trafikut, harron që në përballjen finale nuk ua shkruan dot vetë pyetjet prokurorëve. Në atë përballje do të mbajë përgjegjësi vetëm për përgjigjet", deklaroi kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes dhe riparimit të sistemeve të mbrojtjes elektronike në objektet dhe degët e Bankës së Shqipërisë"**.

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 9,000,000 Lekë**.

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halli", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext.4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë parapajishtë pagesën e paktyshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 2222 222L; BIC

Përkrahimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Shërbimi vjetor i mirëmbajtjes dhe riparimit të sistemeve të mbrojtjes elektronike në objektet dhe degët e Bankës së Shqipërisë"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 20 Nëntor 2017, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

Lejet e legalizimeve regjistrohen përmes portalit "e-Albania" brenda 10 ditëve

Tapia për ndërtimet pa leje, ndryshon procedura

Kostoja e aplikimit, 5 mijë lekë. Dokumentet

Ornela Manjani

Lejet e legalizimeve mund të regjistrohen në Hipotekë brenda 10 ditëve me një kosto prej 5 mijë lekësh, pa qene nevoja të prisni ALUIZNI-n të dorëzohet dosjen në Hipotekë. Personat që kanë ndërtuar pa leje dhe janë pajisur me lejen e legalizimit, mund të marrin tapinë për shërbimet që ofrohen në "e-Albania". Pronari i objektit duhet të identifikohet në faqen zyrtare në internet me numrin e kartës së identitetit, ose pasaportë biometrike (të nevojshme për t'u loguar në portalin "e-Albania") dhe të dërgojë një shkresë përcjellëse nga institucioni që ka lëshuar lejen e legalizimit.

APLIKIMI

Shërbimi elektronik në faqen "e-Albania" u vjen në ndihmë qytetarëve që të dërgojnë një aplikim për regjistrimin e objekteve të legalizuara. Bëhet regjistrimi i objektit të legalizuar menjëherë pas përcjelljes për regjistrim nga Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit, Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale, të lejes së legalizimit dhe dokumentacionit. Regjistrimi kryhet në favor të subjektit, të cilit i është lëshuar leja e legalizimit. Pas dërgimit të aplikimit drejt ZRPP-së, ai do të procesohet nga specialisti i ZRPP-së dhe në varësi të informacionit, kthimi i përgjigjes dhe i materialeve të kërkuara nga kërkuesi kryhet nëpërmjet informimit me email, dërgimit të përgjigjes elektronike të "Dokumentet e mia" në profilin e qytetarit në "e-Albania", si dhe me shërbim postar, nëse qytetari kërkon përgjigjen në format letër. Kërkesa për kryerjen e një shërbimi nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP), në zbatim të ligjit nr. 33/2012, bëhet nga kërkuesi vetë, ose nëpërmjet përfaqësuesit të tij, noterit apo asistentit të noterit. Pranë Zyrave të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme funksionon Regjistri Elektronik i Përpunimit të Kërkesave, i cili garanton trajtimin e praktikave sipas radhës së paraqitjes së kërkesave. Minimalisht, në regjistrë regjistrohen numri i kërkesës, data e paraqitjes dhe data e përfundimit



it të afatit për trajtim, sipas rendit kronologjik. Kërkuesi, që paraqet një kërkesë për kryerjen e një shërbimi nga ZRPP-ja, pajiset me një numër identifikimi të kërkesës dhe kodin e sigurisë, me anë të të cilëve mund të verifikojë gjendjen e trajtimit të kërkesës së tij.

PËRGJIGJJA

Kthimi i përgjigjes elektronike dhe i materialeve të kërkuara nga kërkuesi kryhet nëpërmjet dërgimit të "Dokumentet e mia" në "A-albania" dhe informimit me email për shkarkimin e përgjigjes elektronike. Gjithashtu, nëse qytetari

dëshiron përgjigjen në format letër, e merr nëpërmjet shërbimit postar. Çdo tarifë për shërbimin në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme paguhet në llogarinë bankare të Zyrës së Regjistrimit. **LEGALIZIMET** Sipas ligjit në fuqi, ka

DOKUMENTET DHE PROCEDURA

Dokumentacioni i nevojshëm

1. Dokument identifikimi i përdoruesit, kartë identiteti ose pasaportë biometrike (i nevojshëm për t'u loguar në portalin "e-Albania").
2. Shkresë përcjellëse nga institucioni që ka lëshuar aktin.

Hapat e procedurës

1. Identifikohuni si qytetar, ose si biznes në portal.
2. Zgjidhni shërbimin "Regjistrimi i objekteve të legalizuara".
3. Klikoni butonin "Përdor".
4. Plotësoni formularin elektronik me të dhënat e nevojshme mbi Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, mbi pronën, mbi shërbimin/shërbimet e kërkuara dhe taksat e nevojshme.
5. Klikoni butonin "Dërgo" në faqen e fundit të formularit.
6. Shkarkoni mandatpagesën, me të cilën mund të paraqiteni në bankë për të kryer pagesën e nevojshme.
7. Punonjësi i ZRPP-së proceson kërkesën e ardhur dhe në varësi të vendimit që merret, i kthen përgjigje me e-mail aplikuesit, me URL-në e shkarkimit të përgjigjes elektronike të ruajtur tek "Dokumentet e mia" në "e-Albania", ose me njoftimin e arsyes së refuzimit.

edhe një alternativë tjetër për aplikimin në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, për pajisjen me certifikatë pronësie të ndërtimeve të pajisura me leje legalizimi. Vetë Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Infor-

male aplikon për llogari të personit që ka marrë lejen e legalizimit, duke dorëzuar në Hipotekë të gjithë praktikën ligjore të nevojshme për regjistrimin e pasurisë, shtëpisë apo biznesit.

Aksioni anti-informalitet, lëshimi i kuponit tatimor

Tatimet: Bizneset që gjenden tri herë radhazi në shkelje, mbyllen

Administrata tatimore Abën të ditur se po vijon me kontrole në çdo subjekt që ushtron aktivitet tregtar për zbatimin e ligjit dhe garantimin e kushteve për konkurrencë të ndershme në luftën kundër evazionit dhe informalitetit. Strukturat e zbatimit Task-Forcë të Drejtorisë së Hetimit Tatimor kanë ushtruar kontrole në Tiranë, në zbatim të planit anti-informalitet. Gjatë kontrolleve janë konstatuar problematika për moslëshim të kuponit tatimor, punonjësit të padeklaruar apo subjekte të pa licencuara. Janë bllokuar 6 bare dhe restorante për moslëshim kuponit tatimor (hera e dytë) si dhe dy subjekte tregtare, që ushtronin aktivitet të pa licencuar. Nga 265 kontrole të realizuara, 80 prej tyre janë penalizuar. Masat ndëshkimore për moslëshimin e kuponit tatimor janë si më poshtë:

Moslëshim kuponit hera I: Penalizim me gjobë në masën 50 000 lekë dhe përveç masës së gjobës për tatimpaguesit e regjistruar për TVSH-në, bëhet vlerësimi tatimor për tre muajt e fundit. Moslëshim kuponit hera II: Penalizim me gjobë në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë dhe në këtë rast merret masa e bllokimit të veprimtarisë në vendin ku

është konstatuar shkelja për 30 ditë kalendarike. Moslëshim kuponit hera III: Penalizim me gjobë në masën 50 000 lekë dhe konsiderohet evazion tatimor, duke e kallëzuar subjektin penalisht. Gjithashtu, publikohet emri i tatimpaguesit, NIPT-i dhe emri i përfaqësuesit të biznesit në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Shoqëria përmbarimore "STRATI BAILIFFS SERVICE" Sh.p.k., njofton shpalljen për shfajësim në ankadë të pasurive të paluajtshme:

"Truall", me sipërfaqe 3200 m², ndodhur në Shëngjin, Lezhë, Zona Kadastrale 3126, regjistruar në Regjistrin Hipotekor me nr. 13, datë 31.01.2006, në pronësi të Shoqërisë "Taçi Oil International Trading & Supply Company" sh.a., lënë si garanci hipotekore për Bankën me Kontratë Hipotekë Nr. 449 Rep., Nr. 2115/3 Kol., datë 02.02.2006. Çmimi fillestar i ankandit është 89,600 Euro;

"Truall" së bashku me depozitë karburanti, me sipërfaqe 4419 m², ndodhur në Shëngjin, Lezhë, Zona Kadastrale 3126, regjistruar në Regjistrin Hipotekor me nr. 14, datë 31.01.2006, në pronësi të Shoqërisë "Taçi Oil International Trading & Supply Company" sh.a., lënë si garanci hipotekore për Bankën me Kontratë Hipotekë Nr. 448 Rep., Nr. 2103/3 Kol., datë 02.02.2006. Çmimi fillestar i ankandit është 162,036 Euro.

Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në datë 06.11.2017. Ankandi për pasuritë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00, në ambientin e Shoqërisë Përmbarimore "Strati Bailiff's Service", Rruga "Jordan Misja", Pall. 141/1, Shkalla 1, Ap. 7, Tiranë. Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com

Projektbuxheti i vitit 2018

Infrastruktura, 8 akset që do të jepen me PPP

Projektbuxheti 2018 parashikon 8 koncesione të reja të lojit Partneritet Privat-Publik. Qeveria shqiptare ka parashikuar që të bashkëpunojë me privatën për ndërtimin e një sërë segmentesh të rëndësishme rrugore. Sipas tabelave shpjeguese në relacionin e projektbuxhetit 2018, projektet në infrastrukturë kapin vlerën e 140.6 miliardë lekëve. Ndërtimi i segmentit rrugor Kashar-Rrogozhinë është projekti që ka vlerën më të madhe për vitin 2018 në infrastrukturë. Për Rugën e Arbrit, vitin e ardhshëm janë akorduar 24 miliardë lekë. Për sektorin e shëndetësisë është parashikuar një fond prej 9.5 miliardë lekësh, i cili do të përdoret për ndërtimin e spitalit rajonal të Fierit. Një tjetër kontratë e karakterit PPP parashikohet edhe për ndërtimin e shkollave parauniversitare në Bashkinë e Tiranës. Për këtë projekt parashikohet një fond prej 6.4 miliardë lekësh. Qeveria ka zgjedhur që t'i realizojë këto projekte në bashkëpunim me privatën, për shkak të kostove të larta dhe pamundësisë së buxhetit për të mbuluar shpenzimet.

RRUGËT QË DO TË NDËRTOHEN

1. Aksi Tiranë-Thumanë-Vorë 34.3 mld
2. Rruga Kardhiq - Delvinë 8.6 mld
3. Rruga Kashar - Rrogozhinë 41.5 mld
4. Rruga Milot - Balldren 14.2 mld
5. Rruga Oriku - Himarë 17.8 mld
6. Rruga e Arbrit 24 mld

"Hapet gara për 23 drejtues, jo emërimet për qoka politike"

Shkarkohen 8 drejtorë burgjesh, ministria e Drejtësisë: Rrezikuan sigurinë

TIRANË - Ministria e Drejtësisë, Etilda Gjonaj ka shkarkuar dje nga detyra tetë drejtorë burgjesh në qytete të ndryshme të vendit, pasi nga kontrollat e kryera janë evidencuar shkelje të rënda që rrezikojnë sigurinë në institucionet e vuajtjes së dënimit. Në një dalje për mediat, Gjonaj njoftoi largimin nga detyra të drejtorëve të burgjeve: Rrogozhinë, Lushnjë, Peqin, Lezhë, Sarandë, Berat, Durrës dhe Tepelenë. Sipas ministres së Drejtësisë,

REAGIMI I PATOZIT

Pas "furtunës" në burgje ka reaguar ish-nënkryetari i PD-së, Astrit Patozi. Në një status në "Facebook", ai shkruan se, "ne i paskemi pasur të dënuar vetë më parë gjysmën e drejtorëve të burgjeve në Shqipëri! Siharigjin na e dha vetë ministria e re e Drejtësisë, por pa na shpjeguar se si i kanë ngjitur shkallët e karrierës në administratë të gjithë këta të riedukuar".

krrerët e burgjeve të: Lezhës, Rrogozhinës, Lushnjës, Peqinit, Tepelenës dhe Durrësit janë shkarkuar nga detyra për shkelje administrative dhe shpërdorim detyre. Ndërkohë që drejtori i burgut të Sarandës është shkarkuar për shkelje administrative, ndërsa figuron person i dënuar më parë. Kurse, për kreun i IVP-së Berat është shkarkuar për shkelje administrative dhe



Ministria e Drejtësisë, Etilda Gjonaj

Ministria e Drejtësisë e vendosur për zbatimin e ligjit, nuk do lejojë asnjë shkelje. 88 vepra penale i referohen burgut të Peqinit, ndërkohë 36 vepra të tjera i referohen burgut të Rrogozhinës. Pavarësisht alarmit të vënë nga prokuroria, nuk është vepruar më parë nga ana e kësaj ministrie. Arsyet e mosveprimit mbeten të panjohura", tha Etilda Gjonaj. Ndërkaq, ajo deklaroi se pas këtij vendimi do të hapet gara për 23 drejtues të burgjeve. "Sot (dje) hapim garën për 23 drejtues të burgjeve dhe paraburgimeve në të gjithë vendin. Nuk do të ketë më emërimet për qoka politike, por bazuar tek aftësitë profesionale. Deri në emërimet e reja në krye të burgjeve janë komanduar punonjësit profesionistë", u shpreh ministria.

Arrestohet edhe i dënuari me 6.8 vite burg për tentativë vrasjeje dhe një tjetër

Plagosi në zgjedhje aktivistin e LSI-së, kapet nipi i tjetër i ish-deputetit të PS

Samuel Ndokës iu gjet një pistoletë pa leje



TIRANË

Pak ditë pas arrestimit nga policia e Lezhës e 20-vjeçarit Danjan Ndoka, nip i ish-deputetit socialist Arben Ndoka, dje blutë e kryeqytetit kanë vënë në pranga edhe nipin tjetër të ish-deputetit. Bëhet fjalë për Samuel Ndokën, i cili ishte shpallur në kërkim për disa vepra penale. 18-vjeçari u kap në flagrancë me një pistoletë pa leje. Dy të rinjtë akuzohen për plagosjen e aktivistit të LSI-së, Florian Dushku. Ngjarje kjo e ndodhur në zgjedhjet e 25 qershorit të këtij viti në Lezhë. Lajmi për plagosjen e nipit tjetër të ish-deputetit socialist u bë me dije nga drejtori për Krimet në Policinë e Shtetit, Josif Shtëmbari. Ndërkohë, burime zyrtare nga policia pohuan se bashkë me Ndokën u arrestua edhe shtetasi Paolo Marinaj, i dënuar nga Gjykata e Shkodrës me 6 vite e 8 muaj burg për veprën penale "Vrasje me dashje e mbetur në tentativë". Sakaq, në pranga u vu edhe shtetasi Altin Mikaj, pasi me automjetin e tij tip "Audi" ka transportuar dy personat e mësipërm.

ARRESTIMI

Përgjatë 12 orëve të fundit, Policia e Tiranës ka arrestuar 3 persona me armë, njëri prej tyre në kërkim për disa vepra penale, si dhe një tjetër për "Vrasje me dashje e mbetur në tentativë". Konkretisht u ndaluan shtetasit: Samuel Ndoka, pasi iu kap me vete një pistoletë me 7 fishekë dhe Paolo (Francesk) Marinaj, pasi iu kap me vetë një armë pistoletë, me 7 fishekë si dhe një kreher që e mbante në çantën e krahut me 8 copë fishekë. Të dy këta persona u arrestuan për veprën penale "Armëmbajtje pa leje". Në pranga ka përfunduar dhe Altin Mikaj, pasi me automjetin tip "Audi" ka transportuar

dhe fshehur të dy personat e sipërcituar, duke i ndihmuar për t'iu shmangur forcave të policisë. Ndaj tij u mor masa e arrestit në flagrancë për veprën penale "Përkrahje e autorit të krimit". Sipas burimeve të mësipërme, Samuel Ndoka, banues në Lezhë ishte në kërkim, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka caktuar masën e sigurisë "Arrest me burg" për veprat penale: "Plagosje e lehtë me dashje", "Prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve luftarakë dhe municionit", "Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje". 18-vjeçari në bashkëpunim me shtetas të tjerë, njëri prej tyre i arrestuar në datë 25 qershor 2017, nën kërcënimin e armës kanë kanosur dhe dhunuar ditën e zgjedhjeve të 25 qershorit, shtetasin Florian Dushku.

PLAGOSJA NË LEZHË

Rreth orës 10:15 të 25 qershorit të këtij viti, policia e Lezhës është njoftuar se në Shëngjin të Lezhës, përpara ambienteve të restorant "Detari" ka pasur një konflikt midis disa personave dhe se është qëlluar me armë zjarri. Menjëherë është ngritur grupi hetimor dhe nën drejtimin e Task Forcës pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë, ka kryer të gjitha veprimet hetimore e procedurale për zbardhjen e plotë të ngjarjes. "Nga tërësia e veprimeve hetimore të kryera deri tani ka rezultu-



I arrestuari Samuel Ndoka

ar se ka qenë një konflikt midis dy grupesh personash, i cili fillimisht ka nisur si debat verbal e më pas ka agravuar në konflikt fizik e me mjete të forta mes tyre, si dhe njëri prej personave të përfshirë ka qëlluar me

armë zjarri në ajër. Si pasojë e këtij konflikti ka mbetur i dëmtuar lehtë në kokë shtetasi Florian Dushku, 28 vjeç, banues në Shëngjin-Lezhë. Nga kryerja e veprimeve hetimore e procedurale është bërë i mundur identi-

fikimi i autorëve të dyshuar të kësaj ngjarje: Gentian Marku, 25 vjeç, banues në Lezhë; Samuel Ndoka, 19 vjeç, banues në Lezhë dhe Danjan Ndoka, 20 vjeç banues në Lezhë. Po kështu, në vijim të veprimeve të kryera për këtë ngjarje, është bërë arrestimi në flagrancë i shtetasit: Aleksandër Ujka, 54 vjeç, banues në Shëngjin-Lezhë. Arrestimi në flagrancë i këtij shtetasi u bë për veprën penale "Kryerja e veprimeve që pengojnë zbulimin e së vërtetës", pasi nga analizimi i pamjeve filmike të sekuestruara në restorantin në pronësi të këtij shtetasi janë vërejtur ndërhyrje dhe fshirje të pamjeve filmike të regjistruara në intervalin kohor kur ka ndodhur ngjarja", thuhej në deklaratën e policisë pas ngjarjes.



ish-shefi i Krimeve, Krenar Behari

U arrestua tri ditë më parë, Gjykata e Durrësit liron ish-shefin e Krimeve

DURRËS - Gjykata e Durrësit ka vendosur dje masën e sigurisë "detyrim paraqitje" për nënkomisarin Krenar Behari, i cili u arrestua dy ditë më parë me kërkesë të prokurorit Arjan Ndoja, për moszbatim të urdhrave të tij. Prokurori kishte kërkuar hetimin në gjendje të lirë të një personi të përfshirë në një konflikt, por ish-shefi i Krimeve në

Drejtorinë e Policisë së Durrësit e ka arrestuar. Duke e cilësuar arbitrar veprimin e Beharit, prokurori Ndoja kërkoi arrestimin e tij, duke e akuzuar për shpërdorim detyre. Por, gjykata pasi verifikoi kushtet e masës së arrestit dhe dëgjoi palët, vendosi si masë sigurie "detyrim paraqitjeje pranë policisë gjyqësore", ndërsa hetimet vazhdojnë.

SHKURT

Favorizuan prerjen e pyjeve, perfundojnë

në pranga 2 inspektorë PRRENJAS - Policia e Elbasanit dhe ajo e Prrenjasit, në bashkëpunim me FNSH-në ka goditur një rast të prerjes pa kriter të pyjeve. Në vendin e quajtur "Kthesa e Shëneprentes", pas informacionit të marrë në rrugë operative se në pyllin e Stravajit priteshin pemë për lëndë drusore, blutë bllokuan në orët e para të mëngjesit të djeshëm një kamion të ngarkuar me 20 m3 lëndë drusore të prerë pa leje, si dhe pa faturrë shoqërimi. Në një deklaratë për mediat, drejtori për Krimet në Policinë e Shtetit, Josif Shtëmbari, tha se drejtuesit i mjetit punonte për llogaritje të një subjekti të licencuar nga Bashkia Prrenjas për prerje dhe transport lëndë drusore në ngastrat e damkosura për prerje. Nga hetimet ka rezultuar se inspektori i pyjeve pranë Bashkisë Prrenjas, 28-vjeçari O.L., dyshohet të mos ketë ushtruar kontroll në ngastrat e marra nga subjekti dhe nuk ka marrë masa për parandalimin e prerjes së paligjshme të pyjeve në zonën që mbulon. Ai dyshohet të ketë favorizuar këtë subjekt të presë dru të padamkosura, duke shkaktuar një dëm ekonomik dhe mjedisor. Nga verifikimi i akteve të kontrollit të kryer nga inspektorët e pyjeve pranë Bashkisë Prrenjas, nuk rezultoi asnjë kontroll i bërë në ngastrat që shfrytëzonte subjekti. Ndërsa, 40-vjeçari L.L. me detyrë përgjegjës i Shërbimit Pyjor, Bashkia Prrenjas, dyshohet të mos ketë kontrolluar inspektorin në varësi dhe nuk ka urdhëruar për kontroll në ngastrat që shfrytëzonte subjekti, duke shkaktuar dëm ekonomik dhe mjedisor në këtë zonë. Të dy personat në fjalë u arrestuan, ndërsa akuzohen për shpërdorim detyre. Gjithashtu, ka nisur procedimi penal ndaj drejtuesit të mjetit, 56-vjeçarit R.K., banues në Durrës dhe ndaj përfaqësuesit të subjektit, 48-vjeçarit S.K., banues në Qukës. Këta dy të fundit akuzohen për veprën penale "Prerja e paligjshme e pyjeve".

Qamil Haxhiu, apel policisë: Më ruani vajzën, kam frikë se mund të hakmerren

LUSHNJE

Masakra e Lushnjës, babai i Laert Haxhiut: Nëse im bir ka vrarë, do e var në litar

"Nuk do më dridhet dora, nëse djali del fajtor"

Laert Haxhiu dhe Orges Bilbili që prej datës 11 tetor janë të shpallur zyrtarisht në kërkim nga policia si autorë të dyshuar të vrasjes së dyfishtë, që ndodhi në qytetin e Lushnjës. Burime nga Policia e Lushnjës deklarojnë se dyshohet se dy të rinjtë kanë kaluar kufirin në mënyrë ilegale dhe ndodhen në Greqi. Por, babai i Laert Haxhiut, Qamil Haxhiu, në një intervistë për "Klan Plus", jep një version tjetër nga ai i ngritur nga policia. Ai është i bindur se djali i tij nuk ka qenë autori. "Unë deklaroj se nuk ka qenë djali im, për arsye se djali po të kishte ardhur, do të më kishte takuar. Atë e di policia në radhë të parë, por që të dish një gjë. Në ngjarje të tilla nuk ecet me versione që e ka bërë filani apo e ka bërë ky tjetri. Në ngjarje të tilla duhet të jesh i bazuar në gjëra konkrete. Viktimat që rezultojnë të vdekur asnjëherë nuk kanë pasur problem me djalin tim. Po, siç dihet në qytetin e Lushnjës, gjatë gjithë kohës, personat që e akuzojnë djalin tim bashkë me policinë kanë pasur gjithmonë tendencë tim biri". Por, sipas Qamilit, nëse djali ka kryer krimin, ai do ta varë në litar. "Në rast se e ka bërë, dënimin ia jap unë. Ia vë unë litarin i pari dhe nuk më dridhet dora fare. Ama kur ata ta nxjerrin dja-



Babai i Laert Haxhiut, Qamil Haxhiu



I kërkuari Laert Haxhiu

lin fajtor, ata duhet të nxjerrin versionin e saktë". Sipas tyre, me familjet e viktimave kanë lidhje miqësie. "Jurgeni, Afrimi, Tomorri, ata e kanë dajë burrin e motrës sime. Janë çuna dajash, çuna hallash me nipat e mi dhe nuk kanë pasur asnjë konflikt. Aq më tepër me këtë tjetrin, Zamir Latifin. Unë me këta, me dajat e tyre

jam rritur. S'më ka lidhur ndonjë gjë, ndonjë konflikt me dajat e këtij". Qamili sqaron se djali i tij ka pasur një konflikt dhe ai është me Xhulio Shkurtin, nipin e Aldo Bares në vitin 2016, ngjarje për të cilën djali i tij është dënuar me 21 vite e 8 muaj burg. "Djali në momentin që është përplasur me Xhulio

Shkurtin dhe Sajmo Xhelilin ka qenë sherr momental dhe jo sherr i përgatitur. Nuk kam unë asnjë punë me këta, se po të ishte që do të kishim punë, do t'i kishim zgjidhur ne të mëdhenjtë këto dhe nuk do t'a lija unë atë. Të rritej, ai fëmija im, e të zgjidhte këtë hall që na ka ndodhur në '98 dhe në 2005-ën kur është vrarë nipi. Kësh-

tu që nuk kemi probleme". Për vrasjen e 11 tetorit, Qamil Haxhiu shprehet se është i gatshëm të ballafaqohet me familjarët e viktimave, për t'u dëshmuar se djali i tij nuk ka dorë në këtë krim. Në fund, ai ka një thirrje për shtetin. I kërkon policisë të ruajë vajzën e tij, pasi ka frikë se mund të hakmerren.

Atentati në Lushnjë, autorët dyshohet se janë larguar jashtë vendit me pasaportë false

LUSHNJE - Autorët e atentatit të 11 tetorit në Lushnjë, ku mbetën të vrarë dy të rinj dhe u plagosën dy të tjerë janë ende në arrati. Kur kanë kaluar gati tri javë nga dita kur ndodhi ngjarja e rëndë, policia dhe prokuroria e Lushnjës nuk kanë asnjë informacion për vendndodhjen e autorëve të dyshuar, Laert Haxhiu dhe Orgest Bilbili. Sipas burimeve, autorët e krimit mund të jenë larguar nga Shqipëria drejt Gjermanisë. Por në sistemin TIMS ata nuk figurojnë të kenë dalë nga vendi ynë, çka ngjall dyshimet se ata mund të kenë kaluar kufirin me pasaportë false, ose kanë kaluar nga kufiri tokësor drejt vendeve fqinje. Kërkimet e prokurorisë së Lushnjës për kapjen e autorëve të vrasjes së Jurgeni Hoxhës dhe Zamir Latifit kanë vijuar edhe në rrethin familjar. Prindërit e Haxhiut dhe Bilbilit, pasi janë paraqitur në prokurori, kanë deklaruar se prej disa muajsh përpara vrasjes se dy personave, ata nuk kanë pasur asnjë komunikim me fëmijët e tyre. Gjithashtu, mësohet se janë marrë në mbrojtje dy familjet e autorëve të dyshuar për ngjarjen.

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE. LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA, ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID



Dosja për marrjen e tapisë dorëzohet nga Agjencia e Legalizimeve në Hipotekë

Legalizimet, 2000 personat që kanë gati lejet e banesave

ALUIZNI: Ja kush përfiton në Elbasan dhe zonat përreth

Ornela Manjani

ALUIZNI publikon listën me 2000 per sona që kanë ndër tuar pa leje dhe kanë lejet e legalizimeve. Përfituesit janë në Elbasan. Drejtoria e ALUIZNI-t të Elbasanit njofton qytetarët se duhet të paraqiten pranë zyrate të ALUIZNI-t në Elbasan për të tërhequr lejen ndërmore. Ndërkohë që procedurat për marrjen e tapisë do të ndiqen nga ALUIZNI, i cili dorëzon dosjen e plotë në Hipotekë.

HIPOTEKA
Menjëherë pas regjistrimit të certifikatës së pronësisë, përfituesi do të njoftohet për tërheqjen saj. Pas ndryshimeve të fundit ligjore, qytetari do të marrë një kopje për të vërtetuar mbarrimin e procesit të legalizimit, por e gjithë procedura vijuese për regjistrimin në Zyrën e Regjistrimit të Pa-

surive të Paluajctshme do të bëhet nga Agjencia. Ndërkohë që sipërfaqja e parcelës për të cilën miratohet kalli mi i së drejtës së pronësisë nuk mund të jetë më e madhe se trefishi i sipërfaqes së bazës së ndërimit dhe për ndërimit pa leje me funksion banimi, jo më shumë se 500 m². Sipërfaqet mbi masat e përcaktuara në këtë pikë, të

cilat për shkak të përmasave ose konfiguracionit nuk mund të shfrytëzohen më vete për ndërimit, i shiten poseduesit të ndërimit pa leje sipas vlerës së pronësisë, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, vetëm nëse ka shprehur më parë vullnetin, nëpërmjet një kërkesë me shkrim. Sipas ligjit më fuqi, kur ndërtimi pa

leje disponohet nga një subjekt, kontrata e kalimit të pronësisë së parcelës ndërtime dhe objekt të që legalizohet regjistrohen në emër të subjektit që disponon objektin. Ndërsa në rastin kur ndërtimi pa leje disponohet nga më shumë se një person fizik ose juridik, regjistrimi i pjesëve takuese mbi pasuritë (parcelë dhe objekt) kry-

het: në pjesë të pandara, ideale, sipas numrit të subjekteve; në pjesë takuese të ndara, sipas marrëveshjes së nënshkruar ndërmjet subjekteve lirish dhe të depozituar brenda afatit të vetëdeklarimit. Subjekti mund të përcaktojë përveç pjesës takuese, edhe pjesët fizike respektive nëse ndërmjet tyre përpulthet vullneti.

Table with 4 columns of names: A-G, H-N, O-T, U-Z. Includes names like ENVER, AGIM, SHKURAT, etc.

LUTFIT XHELAL ÇELHEMA
BESHIK GANIÇANI
VELSON HASAN REZAJ

MUHAMMED AHMET PESHKO
BASHKIM ZEBNELI HOXHAJ
ALBERT SHERIF TOSHI

AVNI MUHAREM DEBROVA
REDVAN KADRI VASKA
ALBERT KADRI METALLA

BERMELINDA ISMET GJETA
HASAN SOKOL BARJA
HASAN MUSTAFI SHARRA

EDUART JUSUF SADIKAJ
FATMIR RYZHDI KARZI
AFRIM SEFER DYBELLI

AVNI VESEL HYSA
BULJIF HAQIDEHYSA
FATMIR KASAJ

PROMOVIMI

Ferri i shqiptarëve në romanin e Açkës: Thertorja ku punoja, si Shqipëria në diktaturë

Fatmira Nikolli

- Ç'është ky? S'e kisha dëgjuar ndonjëherë Rrethin e Dhjetë?

-Rrethi që Danteja nuk e kishte menduar kurrë, shtatë shekuj më pas ka njerëz që nuk i nxë asnjë pisëhanë, që kanë aq shumë mëkate e fajë bashkë, që kanë tashmë një kompleks të tillë fajsh të paparashikuara nga Dante.

Për ta nuk ka vend në asnjë rreth të veçantë, sepse ose do të duhet të copëzohen, ose do të duhet një rreth më vete për mishelanenë e mëkateve të tyre, një rreth i dhjetë, që t'ua përfshijë zezomën të gjithëve së bashku".

Është ky "rrethi i dhjetë" i Flutura Açkës, duke qenë njëherësh edhe rrethi i dhjetë i shqiptarëve. Romani i saj më i ri "Të ftuar në rrethin e dhjetë" rrok një histori që përbashkon përmes personazheve Shqipërinë në dhe pas diktature, e shkërmoqur, e vvarë, mes kaosit e kriminit, me ngjarje të bujshme të dhimbshme, me të vobektë që enden këtej e matanë kufijve, me njerëz të ikur e që duan të ikin. Një histori gjaku parë nga brenda dhe jashtë, me rrëfime të autoreve herë si protagonistë e herë si spektatore, as larg as afër, por tërësisht e përfshirë me hapat e ngadaltë dhe të dhunshëm të dekadave që shkojnë duke lënë pas gjurmë frike dhe një shoqëri që endet mes shpresës së paplotë.

Një kryeministër që flet me një fjalor në kufijtë e doracakut të të rrycave të Babrusë, që i drejtohet në mes të një darke, një zonje të lartë me fjalët "erdhe kurvë, të vonoi parukierja?"; i biri i një personazhi që di si ta dredhë në çdo kohë, një kameleon, një skile e vjetër; Orikumi ku kanë mbjellë më shumë palatë se pemë se këta jemi ne, mjeshtër, nuk ditëm ta bëjmë të bukur Shqipërinë; një agjenci funerale përballë një spitali fëmijësh, qivurë përballë jetës; 1997-a baba ku u vranë e u plagosën në fushatë 100 vetë, me paratë e vjedhura nxisnit njerëzit drejt dhunës, ngaqë nuk ju hoqën me gjak, e morët me gjak dhe e dogjët Shqipërinë bashkë, do të mësojnë edhe ata ta marrin me gjak se 21 janari tregoi se kishin mësuar prej jush - jeni njësoj;

Drogë, korrupsion, politikë dhe krime - imazhi i një vendi në "Të ftuar në rrethin e dhjetë"

"Më vjen turp të shoh Nexhmije Hoxhën të japë intervista pa e denoncuar gjenocidin komunist"



Flutura Açka dhe Mustafa Nano

gazetat italiane që shkruajnë për parcela hashashi përtej Lazararit dhe në fund -jeta është e gjatë për të bërë gjërat që dëshiron në emër të dashurisë, se sot kemi nevojë të jetojmë homeriken, shpirt. Dantesken më vonë, Beatricja ime!

Siç shënon vetë autorja Flutura Açka, romani "Të ftuar në rrethin e dhjetë" ndërtohet në të njëjtën shtjellë me rrathët e ferrit të Dantes, citime të të cilit në vepër janë të shpeshta, sipas përkthimit të Pashko Gjeçit. Vepra ndërtohet mbi digresionin në 50 vitet e fundit të historisë shqiptare, e përcuar përmes jetës së tre personazheve themelore të romanit. "Rrethi i dhjetë" është rrethi metaforik mbi shumësinë dhe kompleksitetin e mëkateve të aty-



re që drejtuan Shqipërinë në 50 vitet e fundit, një vend në askundin e harrës dhe të gjykimit. Vepra ka linja të shumta dhe është pasqyrimi i rrugëtimit të për-

bashkët të mijëra shqiptarëve, që e lanë Shqipërinë pas rënies së diktaturës.

PROMOVIMI

Firence, qershor 2016. Tre miq të vjetër qysh nga fëmijëria, të cilët e kanë lënë Shqipërinë në rrethana dhe në kohë të ndryshme pas kapërcyellit të 1990-tës, vendosin të festojnë së bashku 50-vjetorin e lindjes. A janë ata të përgatitur ta fshijnë të shkuarën shqiptare, e cila befasi ende ua dikton dhe ua helmon ndonjëherë jetën? A do të mundën ata të mbeten miq edhe pas shqyrtimit që ky takim i pafajshëm do t'u kërkojë, shqyrtim që shpesh nuk lidhet me ata vetë, por që kryqëzohet dhe ndikon në jetët e tyre? Ky rrëfim është një kushtim për dashurinë

njerëzore, për dashurinë si sublimim që nuk e zhbën koha dhe një triumf për atdhedashurinë, të tretura në gjakun shqiptar nga substanca më e bekuar e kësaj bote: Liria.

Të premtën në mbrëmje, mes të ftuarve të shumtë shkrimtarë, dashamirës të letrave, a të ardhur enkas nga Holanda ajo e promovoi romanin "Të ftuar në rrethin e dhjetë" teksa artistja e Popullit, Tinka Kurti, që Açka iu drejtua edhe si nënë, recitoi dy poezi nga vëllimi i fundit "Ptesë për flirrt". Vetë Açka lexoi një pjesëz nga romani, veçmas nga "Fillesa". Mbrëmja shënoi edhe një besëdë me publicistin e njohur Mustafa Nano mbi temat e librit dhe çështjet e Shqipërisë së sotme.

"Kur kritikoj nuk pozicionohem si holandez. Unë jetoj me realitetin në Shqipëri. Komunizmin e njoh mirë, sepse e kam jetuar. Nuk e kam bërë me qëllim. Jam rritur në atë kohë dhe e kam ndjerë se duhet ta them e ta lë si dëshmi. Isha ekonomiste në thertore dhe më kujtohen thikat atje. E kam parë diktaturën në miniaturë në atë thertore. Nga ato thika, nga ai gjak, unë shihja Shqipërinë e kohës, ashtu ndodhte dhe jashtë thertores", tha Açka. Shprehu keqardhje se nuk kemi bërë denoncimin e diktaturës e të gjenocidit të saj. Ndaj, pas 30 vitesh jemi në vitin 0 sipas gjykimit të Açkës.

"Jemi një vend ku Nexh-

mije Hoxha jep intervista. Më vjen turp për median. Më vjen turp ta shoh. Ajo nuk ka kërkuar kurrë falje. Si mund të dalë të japë intervista, pa e denoncuar gjenocidin?!"

Kur Mustafa Nano e pyeti nëse duke denoncuar komunizmin, Açka një farë mënyre po denoncon edhe Gramoz Ruçin, shkrimtarja mohoi. "Jo, s'e kam menduar. E kam parashikuar si duket".

Biseda preku edhe çështjen e religjioneve, duke u ndaluar kryesisht tek islami. "A është e lirë një grua myslimane e mbuluar", pyeti Nano, por çka Açka tha se "Po. Unë them se po. Kam disa mikeshat të mbuluara në Holandë dhe kam kuptuar që kanë mënyrën e tyre të mendimit. Kam dëshirë të besoj se janë të lira. Kam dëshirë të besoj se është zgjedhje e tyre".

Në të njëjtën temë, Nano tha se deri më 1939 në vendin tonë ka pasur kompaktësi, më pas erdhi komunizmi që zhdukua fetë dhe ne nuk e bartëm problemin fetar. "Tani ka dalë si një problem spektakolar. Ka edhe fanatizëm. Sot shoh që për herë të parë në historinë e kombit shqiptar kemi probleme me religjionet. Ke frikë dhe nëse po, mendon kështu?", tha Nano, ndërsa Açka u përgjigj se "shoh harmoni mes feve me njëra-tjetrën, klerikët shihen bashkë nëpër festa. Mungesën e harmonisë e shoh jo mes feve njëra me tjetrën, por mes feve e njerëzve. Ata vetë janë fare mirë. Jam e shqetësuar si patriotë. Po. Dhe jam e shqetësuar se pse para 10 vitesh ishte tjetër panoramë e sot kemi këtë".

Themelohet Akademia Ballkanike Europiane

Me moton "Ballkani është zemra e Europës", shprehje e shkrimtarit zviceran Nicolas Bouvier, u themelua në Bukuresht, më 21 tetor 2017, Akademia Ballkanike Europiane - institucioni i parë kulturor që e trajton Ballkanin si tërësi qytetërimesh dhe si pjesë e trashëgimisë sonë të përbashkët europiane. Takimi i parë i Komitetit Themelues u organizua në shkurt 2017 në Shkup, me pjesëmarrjen e pesëmbëdhjetë krijuesve ballkanas të njohur ndërkombëtarisht dhe nën



drejtimitin e kryetarit të Akademisë Europiane të Shkencave, Arteve dhe Letërsisë, Jean-Patrick Connerade. Në këta shtatë muaj Komiteti Themelues ka propozuar që të jenë gjithsej tridhjetepesë anëtarë nga dhjetë vende: Rumania, Greqi, Bullgari, Turqi, Serbi, Shqipëri, Bosnje, Maqedoni, Mali i Zi dhe Kosovë. Kryetarit i parë i Akademisë është regjisorit i teatrit Ion Caramitru, drejtor i Teatrit Kombëtar të Rumanisë, ish-ministër i Kulturës. Sekretar i Përgjithshëm është Jordan Plevnesh, shkrimtar maqedonas dhe president i Festivalit të Filmit dhe Teatrit të Eu-

ropës Juglindore (Paris-Berlin). Si anëtar nderi është propozuar shkrimtari turk, Orhan Pamuk. Ndër anëtarët e Akademisë është edhe poetesha e shqar rumune Ana Blandiana. Nga Shqipëria, në takimin themelues mori pjesë shkrimtari Bashkim Shehu. Anëtarë të tjerë nga Shqipëria janë kinoregjisorit Kujtim Cashku dhe muzikologu Vasil Tole. Kosova do të ketë dy anëtarë, ndër të cilët Veton Nurkollari, themelues dhe drejtor Artistik i festivalit më të madh kinematografik të Kosovës; është propozuar edhe aktorja e njohur, Arta Dobroshti.

E DIEL
29 Tetor
2017



Një “Mace e zezë” në stadium

Kushtuar fotos shqiptare, që mori çmim në “Word Press Photo” në Moskë ‘61



NGA BEN ANDONI

Për ata që nuk e njohin, emri i Petrit Kumi, duket fillimisht si një emër i largët dhe disi i mbetur larg, anipse i gdhendur në rreshtin e nderit të personazheve të historisë së fotos shqiptare. Por, ja që nuk ndodh kështu. Petrit Kumi mbase është larguar nga e përditshmja e fotos, por ka mbetur një nga emrat më të respektuar të qytetit tonë dhe një njeri

tejet i angazhuar. Falë tij dhe pak njerëzve si ai, që sot nuk janë më, ne kemi pulsimin e qytetit, zhvillimin e tij, por edhe rritjen e Shqipërisë në disa fusha. Është e vërtetë që Petrit Kumi i ka marrë të gjitha meritat që i takonin zyrtarisht, por për pak njerëz të tillë si ai, që i kanë shërbyer vendit në çdo kohë, vlerësimi është fare pak para respektimit moral që ne duhet të kemi për ta. Ndoshta besnik i kësaj thirrjeje ka qenë studiuesi i pasionuar Qerim Vrioni, që shquhet për qëmtimin e gjërave të veçanta që lidhen

me foton shqiptare dhe jo vetëm. Me pasionin e tij dhe punën sistematike kemi

ieri të njohur të kohës dhe mjeshtëria e tij është e fiksuar bash në momentin e

Për mjeshttrin Petrit Kumi

shqyrtime interesante për jetën e shumë artistëve të fotos, por edhe histori të tëra fotosh, që kanë bërë historinë e vendit.

Në rastin tonë, kemi botimin e një shkrepeje që i është bërë një kapje të jashtëzakonshme të një port-

caktuar nga Kumi. Tre janë personazhet kryesor të fotos (përveç të katërit... topit të futbollit), portieri kavajas Shefqet Topi, mbrojtësi po kavajas Nazmi Maxhuni dhe sulmuesi tiranas, Bahri Ishka, të tre me karriera të

spikatura në kampionatet shqiptare të futbollit. Natyrisht, qendra e fotos i takon portierit Topi, pas tij Maxhunit dhe i treti Ishka, në pjesën e djathtë fotos, na thotë historiani i fotos.

Por Kumi nuk na ka dhuruar vetëm këtë foto. Prej tij kemi një galeri të tërë personazhesh, ngjarjesh dhe kompozimesh kudo në Shqipëri, që e tregojnë një njeri me interesa të larta në artin e fotografisë por edhe shumë i vëmendshme në prirjet e kohës. Kjo e bën artin e tij të fotos edhe sot shumë interesant, por edhe

të këndshëm. Fotografia e tij s'është thjesht histori, por të jep dhe një kënaqësi mirëfilli estetike, mu atë që e shikon me shumë kujdes Vrioni dhe i jep përcaktimet e tij. Petrit Kumi, në ditët tona, është një profesionist i moshuar, me të cilin ndahet këndshëm përvoja e jetës, që t'i i merr këshilla dhe mund t'i dëgjosh fjalën e mirë për artin, kulturën dhe zhvillimin e vendit.

Nëse Shqipëria do të ketë ndonjë ditë muzeun e saj të fotos, punët e tij do të kenë një vend të merituar sepse janë një tregues i bukur i vetë historisë së Shqipërisë.

N

NGJARJE

Fotografia “Macja e zezë” e Kumi është vlerësuar me medalje nderi për fotografimin sportive në konkursin ndërkombëtar “World Press Photo” të vitit 1961 në Moskë. Një vit më herët, më 1960 në Beograd, Petrit Kumi është nderuar me “Diplomë”, për foton “Brigjeve të Adriatikut” (1959) në konkursin ndërkombëtar të talenteve të reja të fotografisë. Petrit Kumi mbetet një nga figurat më të njohura të fotogazetarisë shqiptare, ai mban titullin “Artist i Merituar” dhe vlerësimin “Mjeshtër i Madh” i Republikës së Shqipërisë.

Një “Macja e zezë” në stadium

NGA QERIM VRIONI

PAK HISTORIK MBI FOTOGRAFINË E SPORTIT NË VEND

Fotografia e sportit, përgjithësisht përbën një degë të fotogazetarisë. Historikisht në botë, “fotografia e sportit ka bërë një rrugë të gjatë qysh prej analizave të hershme të Muybridge me vrapimet e kuajve” (Ang Tom—Photography—The definitive visual history—DK, Neë York, 2014, f.356). Fotografia e parë shqiptare me këtë temë (me të dhënat e deritanishme) daton tetorin e vitit 1913. Në foto paraqiten në fushën e lojës dy skuadra futbollit, ajo e ushtrisë Austro-hungareze (të dislokuar në veri të vendit) dhe skuadrës së Shkodrës, “Independencia” të rreshtuara para një ndeshje midis tyre. Autori i fotos mbahet mjeshtri aparatit, Fel Marubi (Marubi—Njerëz në Za e sende të kujdesshme—Fototeka Kombëtare Marubi, Shkodër, 2012, f.292). Më pas, në lamin e fotografisë së sportit u pasqyrua gjerësisht edhe Rrethi i parë ciklistik i vendit (mundet i pari në Europë) në vitin 1925 nga fotografi Shan Pici, me shumë gjasa, fotoreporteri i parë sportiv shqiptar (Shan Pici—Fotografi i dritës—Gazeta “Shqip”, 24 dhjetor 2013). Përveç këtyre foto sporti kanë realizuar edhe Kol Maca, Gegë Marubi e Ymer Balli.

Më 28 nëntor 1935 nisi publikimin në Tiranë e përjavshmeja e quajtur “Sporti Shqiptar”, ku veprimtaritë sportive shoqërohen edhe me fotografitë përkatëse, kryesisht të vendit. Gjithashtu, mjaft foto sportive janë botuar në atë kohë edhe në revistat e njohura politiko-shoqërore “Minerva”, “Java” etj. Pas vitit 1944, nisi botimin në Tiranë, gazeta javore “Sporti Popullor” (më pas dy herë në javë), që shoqërohej vazhdimisht me foto sportive, sidomos të fotografëve si Prokop Kureta, Enver Shabani, Adnan Hyka etj. Ky i fundit ka hapur, me gjasë, të parën ekspozitë të fotografisë sportive shqiptare (kryesisht të futbollit) në Tiranë në vitin 1998, veçse pa jehonën e duhur për ngjarje të tilla. Gjithsesi, mendohet se fotografia më e njohur dhe e vlerësuar shqiptare sportive, brenda dhe jashtë vendit, mbetet ajo e fotografit Petrit Kumi, e titulluar “Macja e zezë” e vitit 1961. Ato kohë, Kumi punonte pranë ATSH, si fotoreport-er, por jo i mirëfilltë i sportit.

PETRIT KUMI

Petrit Kumi, autori i fotos së mësipërme, është lindur në Elbasan më 20 maj 1930. Në mesin e viteve '50 mbaroi Liceun Artistik



Ndeshja e dytë e kampionatit në stadiumin «Dinamo», «17 Nëntori» - «Besë». NE FOTO: Portieri i «Besës» Sh. Topi me kërcim akrobatik shpëton situatën nga gjuajtja e lojtarit të ri kryeqytetas Ishka. (Foto P. Kumi)

Botimi i parë i fotos, 1 mars 1961

Personazhet e fotos

Tre janë personazhet kryesorë të fotos (përveç të katërtit... topit të futbollit), portieri kavajas Shëfquet Topi, mbrojtësi po kavajas Nazmi Maxhuni dhe sulmuesi tiranas, Bahri Ishka, të tre me karriera të spikatura në kampionatet shqiptare të futbollit. Natyrisht, qendra e fotos i takon portierit Topi, pas tij Maxhunit dhe i treti Ishka, në pjesën e djathtë fotos.

për fotografimin sportive në Konkursin Ndërkombëtar “World Press Photo” të vitit 1961 në Moskë. Një vit më herët, më 1960 në Beograd, Petrit Kumi është nderuar me “Diplomë”, për foton “Brigjeve të Adriatikut” (1959) në konkursin ndërkombëtar të talenteve të reja të fotografisë. Petrit Kumi, mbetet një nga figurat më të njohura të fotogazetarisë shqiptare, ai mban titullin “Artist i Merituar” dhe vlerësimin “Mjeshtër i Madh” i Republikës së Sh-

PERSONAZHET E FOTOGRAFINË

Tre janë personazhet kryesorë të fotos (përveç të katërtit... topit të futbollit), portieri kavajas Shëfquet Topi, mbrojtësi po kavajas Nazmi Maxhuni dhe sulmuesi tiranas, Bahri Ishka, të tre me karriera të spikatura në kampionatet shqiptare të futbollit. Natyrisht, qendra e fotos i takon portierit Topi, pas tij Maxhunit dhe i treti Ishka, në pjesën e djathtë fotos.



Foto Qerim Vrioni, 2014

Petrit Kumi



Shëfquet Topi (Kavajë, 1934-Kavajë, 1998)-Ka luajtur kohën më të gjatë si portier i skuadrës “Besë” e Kavajës për disa vite me rradhë, i shquar për pritje spektakolare. Fillimisht ka luajtur me skuadrën “Partizani” (1956-1958), mandej me ekipin kavajas deri nga fillimi i viteve '70, kur ndërpreu pjesëmarrjen zyrtare në sportin e futbollit. Topi është aktivizuar dy herë me Kombëtaren e Shqipërisë, ku veçohet ajo ku skuadra jonë fitoi për herë të parë në kualifikimet europiane dhe botërore, në ndeshjen me Danimarkën, 1:0 në Tiranë, më 30 tetor 1963.

Nazmi Maxhuni (Kavajë, 1938-Durrës, 2014)-Mbrojtës, fillimisht i aktivizuar me skuadrën e qytetit të lindjes, më pas me atë fqinje, “Lokomotiva” e Durrësit. Ai ka luajtur me qindra ndeshje kombëtare dhe 8 ndërkombëtare me “Besën” dhe “Lokomotivën”. Shquhej për trupin e tij të gjatë, të fortë e të shpejtë, që përgjithësisht u krijonte vështirësi sulmuesve kundërshtarë për të gjetur portën pas tij. Pas lënies së futbollit, Maxhuni, si tifoz i thekur gjerman, në vitet '90, krijoi në Durrës Shoqatën e Futbollit “Gerd Myler”, për nder të golshënuesit të njohur gjermano-perëndimor të viteve '70. Ai u dallua edhe në lëvizjen për demokraci në fillim të viteve '90 në qytetin e Durrësit, shtojmë se Nëna e tij ishte vajza e atdhetarit të shquar, Isa Boletini.

Bahri Ishka (Tiranë, 1944-Tiranë, 2007)-Sulmues i ekipit të “17 Nëntori” i Tiranës qysh prej moshës 17-18 vjeçare. Së toku me mjaft bashkëmohatarë të tij, krijoi shenjzën e njohur të futbollit tiranas shumë të suksesshëm të fundit të viteve '60, që i dha tonin këtij sporti. Ka luajtur rreth 300



...nga numri i shkuar

"Milosao" e këtij numri iu kushtua Robert Elsie. Duhet të sqarojmë se redaktori kishte pak mundësi zgjedhje, ndërsa shkërimet kilometrike nuk reshtnin dhe në këtë numër. U bë një zgjedhje e tillë, që vendi kryesor iu la një studiuese, që nga mbiemri, duket se jeton jashtë, ndërsa pastaj vijuan shkërimet kilometrike për Dritëro Agollin. Intervista, që kishte përgatitur ajo, ishte marrë shumë vite më parë. *I ftuar në katedrën e albanologjisë në Mynih në vitin 2002, studiuesi Robert Elsie mbajti një ligjëratë për bektashinjtë, në një sallë në katin e sipërm të godinës kryesore të universitetit. Titulari i katedrës, profesori Bardhyl Demiraj, përpara se t'i jepte fjalën, bëri një paraqitje të shkurtër të*

botimeve të tij. "Më duket sikur po dëgjoj nekrologjinë time", e mori fjalën duke qeshur Elsie. Natyrisht qeshën edhe të pranishmit. Pas ligjëratës u ulën në një kafene pranë universitetit për të më dhënë intervistën që më kishte premtuar, e cila ishte pjesë e një projekti që, për fat të keq, rasti e solli të mos realizohej kurrë, kështu që edhe intervista mbeti e pabotuar, shkroi ai. Autorës i erdhi keq që intervista u botua shumë vonë, ndërsa nuk i pëlqeu fare vonesa e Milosao. Shpresojmë që të na mirëkuptojë.

Shpëtim Çuçka në pozicionin e përkthyesit, por këtë herë dhe studiuesit vazhdon shkërimet e tij të stërgjatë për Dritëro Agollin, që ka të ngjarë të vazhdojë deri në fund të vitit. Këtë herë argumenti që nxorëm ishte përkushtimi i Dritëroit ndaj njeriut të thjeshtë.

Vetë redaktori shtoi diçka për rëndësinë e një panteoni kombëtar, që të shërbejë si vend edukimi për brezat. Ata që bënë shumë për këtë vend meritonë dhe një vend prehje që të jetë sublim, sepse edhe të vdekur ata të mësojnë me veprimtarinë dhe aktin e tyre. Por, për këtë s'ka zëra ndër shqiptarët, që ngrihen më shumë për të përdhosur dhe anatemuar gjithkënd. Dhe, po vetë redaktori shtoi edhe diçka që lidhet me librin më të ri studimor për fetë abrahamicite, realizuar nga teologu Ermir Gjinishi.

Gjëja e këndshme në këtë numër ishte një cikël me poezi i një poeti rus, që ka jetuar gati njëqind vjet më parë. Velimir Hlebnikovi zë një vend të veçantë në historinë e letërsisë ruse. Ai është një nga figurat më të shquara të avangardës së futurizmit rus, një reformator i guximshëm

i gjuhës poetike. Stili i tij vlerësohet nga studiuesit si një stil që karakterizohet nga një flori jashtëzakonisht që thyen normat e sintaksës dhe shfrytëzohet në mënyrë aktive tropin e personifikimit dhe pleonazmat, vlerat e shtuara të tyre; për të është i rëndësishëm kombinimi i sistemit figurativ, shkroi përkthyesi, që e kish punuar me shumë skrupulozitet. Autori që e solli ishte Vangjush Ziko, që bëri përkthimin dhe që konkludoi për Milosao-n se është tejet i vështirë, pasi është gati e pamundur të sjellësh në gjuhë tjetër tërë enigmat e krijimtarisë së tij unikalë. Hlebnikovi ëndërronte të krijonte një gjuhë universale nëpërmjet poezisë së tij. Në përgjithësi numri ishte i mirë dhe tepër domethënës, por pak e tepruar me shikimi dhe stërgjatë. Redaktori ka frikë se do të vazhdojë edhe për pak kohë në këtë mënyrë.

ndeshje, më e veçanta ajo me "Ajax" e Amsterdemit, në Tiranë më 1970 me rezultatin 2:2, holland- ezët atëherë ishin jashtëtoksorë në futbollin evropian. Me ekipin kombëtar, Ishka është aktivizuar 3 herë. Pas lënies së futbollit si lojtar, më 1972, ai u kthye në stud- jues shkencor sportiv për këtë lojë kaq popullore, fushë ku mori gradën Prof.Dr. Ndërkohë u aktiv- izua edhe si trajner futboli.

Fatëkeqësisht, asnjë nga të tre personazhet e fotos tonë, tani nuk jeton më, por në sajë të fotografisë së njohur "Macja e Zezë" të mjesh- trit Petrit Kumi, ata jetojnë para syve të mijra shikuesve të fotos. Madje, ata do të kujtohen jo vetëm nga bashkëkohësit dhe të njohu- rit e tyre, por edhe nga brezat e ardhshëm, dashamirë të lojës top- kamb, sidomos për lidhjen midis tyre dhe topit në minutën '28 të ndeshjes.

Minuta e 28

Kjo fotografi, është e njohur me titullin metaforik, "Macja e zezë". Vet Kumi shprehet (bisedë, 15.9.2016) se "e kishte dëgjuar këtë pagëzim nga komentatori i njohur i futbollit, Anton Mazreku, gjatë transmetimeve të ndeshjeve në Radio Tirana". Atij i ishte dukur mjaft i përshtatshëm për foton me Shefqet Topin. "E titullova kështu, dhe emërtimi doli shumë i mbarë". Fotoja është realizuar gjatë ndeshjes së javës së parë të Kampionatit Kombëtar të Futbol- lit të vitit 1961 në Stadiumin "Di- namo" (sot Selman Stërmasi) të kryeqytetit në datën 26 shkurt 1961 ndërmjet skuadrave të kategorisë së parë, "17 Nëntori" i Tiranës dhe "Besa" e Kavajës. Sipas një shkri- mi mbresëlënëse të mikut tim, gaze- tarit shumë të njohur sportiv Be- snik Dizdari në gazetën "Panora- ma" (3 shkurt 2016), nga i cili janë marrë mjaft të dhëna, ndeshja për- fundoi 1:0 për tiranasit. Pak ditë pas ndeshjes, fotografia u botua në faqen e parë të numrit të datës 1 mars 1961, të gazetës "Sporti Popul- lori". Sipas Dizdarit, fotoja pas- qyron një pritje spektakulare të portierit Shefqet Topi, në minutën e 28 të pjesës së parë të ndeshjes. Topi i futbollit i kapur mjeshhtë- risht me një hedhje-pritje, ndoshta historike, nga portieri kavajas, si- pas Petrit Kumi, është gjuajtur nga sulmuesi e më vonë trajneri i Tiranës, Enver Shehu.

Mjeshtri Kumi, flet gjerë e gjatë për këtë fotografi me një kujtesë të freskët. Ndër të tjera ai shton se "ato kohë portieri Shefqet Topi shquhej për ato lloj hedhje të veçanta dhe e kam nd- jekur disa javë për ta fotografuar: Unë nuk shihja ndeshjen, por pris- ja rastin kur të gjuanin sulmuesit dhe ai të bënte pritjen e unë ta foto- grafoja". Synimi i fotografit ish- te largëpamës, ndoshta ai mendon-



Tre personazhet e fotos sonë

Fatëkeqësisht, asnjë nga të tre personazhet e fotos tonë, tani nuk jeton më, por në sajë të fotografisë së njohur "Macja e Zezë" të mjeshtrit Petrit Kumi, ata jetojnë para syve të mijra shikuesve të fotos. Madje, ata do të kujtohen jo vetëm nga bashkëkohësit dhe të njohurit e tyre, por edhe nga brezat e ardhshëm, dashamirë të lojës top-kamb, sidomos për lidhjen midis tyre dhe topit në minutën 28 të ndeshjes.

te se pritjet akrobatike (që në të vërtetë zgjasnin fare pak sekonda) të Topit nëpërmjet fotografimit të

tij, të përjetësoheshin për shikues të shumtë e me numër të pafund- më (magjija e fotografisë...). Ai



vazhdon, se "fotografia nuk ishte rastësi, mbasi ai kish kohë që men- donte për të, por ndoshta rastësi ishte se fotoja u arrit vetëm me një shkrepje", gjë fare e rrallë në foto- grafi.

Aparati i përdorur ishte "Praktica", prodhuar në ish-Gjer- maninë Lindore (DDR), nga ku vi- nin edhe filmat. Fotografia është me teknikën bardhë e zi dhe është mjaft e pastër teknikisht, ndonëse përngrinë një çast të një lëvizje të shpejt. Fotografi ka mundur të gjëj me sukses raportin më të mirë ndërmjet madhësisë së hapjes së diafragmës dhe kohës së mbajtjes çelur të obturatorit. Natyrisht e mbarë ka rezultuar vendvendos-

ja e fotografit dhe kuadrimi i pamjes. Në qendrën optike (gjeometrike) të fotos ndodhet mbrojtësi Maxhuni, ndërsa qën- dra e vërtetë, të themi kuptimore ose e rëndësës, e fotografisë mbe- tet trupi i portierit Topi. Pra në foto, qendra gjeometrike dhe ajo kuptimore nuk përputhen me njera-tjetrën e, shikimi lëviz hori- zontalisht sa nga njeri tek tjetri, diçka më gjatë mbetet te njolla e zezë e trupit të portierit (ato kohë kostumi i portierëve ishte përgjithësisht i zi). Sfondi i fotos ka dy pjesë, tribunën me specta- torët dhe qiellin mbi ta. Spektatorët përbëjnë një rresht të gjatë, thua- jse horizontal, që pret të gjithë fo- ton, gama e tij është e përafërt me atë të fushës së lojës. Dita ishte plotë diell, prandaj qielli është fare i pastër në foto, po me një të hirtë neutrale. Kjo i shkon mirë fotos në krahasim me një qiell me re e drama- tik, që do çvendoste për qen- drimin e shikuesit edhe te to.


Nuk mendojmë se do kishte dalë më mbresëlënëse fotoja nëse do ishte me ngjyra, përkundrazi, shpesh këto foto (me ngjyra) të kthyer në b/z, kanë dalë më të goditura e me më tepër vlera este- tike e ndjesore. Po ashtu, sfondi qiellor, e nxjerr shumë në pah figu- rën e portierit duke kapur topin, me një kontrast thuajse të plotë bardhë e zi. Çasti i mbarë (ose siç e quan mjeshtri Cartier-Bresson, çasti vendimtar) i shkrepjes e ka gjetur portierin në pikën kulmore të hedhjes, sepse nëse do të ishte kapur ndonjë të dhjetë të sekondës para ose pas, trupi do kishte për sfond tribunën e spektatorëve dhe nuk fotoja nuk do kishte këtë kon- trast tonal kaq interesant. Hijeshinë e imazhit fotografik e ndihmon edhe bluza dhe getat me vija (tip zebret) të Maxhunit për t'i shtuar joshjen, po ashtu edhe hyr- ja (njolla e bardhë) e spektatorëve në të djathtë të shikuesit të saj.

Fotografia "Macja e Zezë" e Petrit Kumi, hynë në gjininë e foto- grafisë sportive, por ngërthen edhe vlera të veçanta estetike e dokumentare. Ajo mbetet, siç u tha edhe më sipër, njëkohësisht fotografia sportive më e njohur sh- qiptare brenda e jashtë vendit (deri tani), ose më ndryshe, një ikonë e vërtetë e saj. Natyrisht, edhe fati deshi që në atë ndeshje, Petrit Kumi të mos fotografonte ndonjë gol, që përbën pikën kul- more në lojën e futbollit gjithash- tu edhe ëndrën e çdo fotografi, por të kapte një hedhje-pritje të rrallë në një foto të pazakontë sportive, madje edhe vetëm me një shkrepje. Kështu, ajo do mbetet gjatë në kujtesën e dashamirëve të futbollit, por edhe të fotografisë, duke fituar edhe një vend të meri- tuar në Historinë e Fotografisë Sh- qiptare.

A

ARGUMENT

Poemat e D. Agollit nuk na lënë të flemë gjumë rehat, të gogësitim duke hequr dorë nga çdo e vrrarë e mendjes. Ne duhet të vendosim ta lexojmë këtë poet, këtë shkrimtar, apo ta lëmë të pluhuroset në raftet e bibliotekave dhe të nxitojmë në kafene për muhabet (e ç'i ka mbetur tjetër banorit të sotëm)?



Dritëro Agolli

“Poezia e një poeti është biografia e tij”

NGA SHPËTIM ÇUÇKA

Vijon nga numri i kaluar

15.
Poema “Dashuri dhe ferrobeton” (1962) mund të mos na tingëllojë ndjellëse që në titull: E ç’lidhje paska dashuria me ferrobetonin (betonarmenë)? Madje ç’lidhje mund të ketë vetë veprimtaria e hollë poetike me ferrobetonin?

Le të dëgjojmë përgjigjen në vargje të poetit:

Këtu nuk merren me kotësira erotike,
Që bien erë parfum të modës së vjetër,
Këtu ka front
Dhe fronti ka frymë epike:

Beton,
motorë,
tela,

tunele,

gurë të egër;

Këtu nuk ka biseda të vakëta:

“Më lejoni të njihemi!”

“Pardon!”

“Diku ju kam

parë!”

“Pupu, ç’ju shkon kjo jakë,

kjo kravatë!”

“Oh, ç’novelë dashurie!

Kam qarë!”

Këtu gërhet,

gërvishit,

gërmon kompre-

sori

Dhe vinçi kovën me beton e hedh në digë.

.....

...Në mbrëmje,

majë Shkopetit del ylli,

Dhe katër sy

majë Shkopetit yllin kërkojnë:

“Është yni,

është yni,

është yni!”

në krah të njëri-tjetrit thonë.

.....

Urra!

Urra!

Njëqind herë urra

Për dashurinë e teknikut dhe

hidraulistes,

Që kotësira parfumes nuk ka,

As gogësima

në frona

lulishtesh!

Sot është shumë e vështirë, praktikisht e pamundur, që njerëzit të përfytyrojnë të tilla lidhje dashurie, në të tilla mjedise kantieresh të mëdha hidrocentrale. Është shumë e vështirë të përfytyrojnë se si edhe në vitin 1962 Shqipëria kishte mungesa të mëdha për ndriçimin elektrik. Është shumë e vështirë të përfytyrojnë se si lidhjet martesore me dashuri nuk ishin aspak dukuri mbizotëruese shoqërore. Dhe natyrisht duket e çuditshme, madje e pakuptueshme, se si mund t’i thuret një poemë një bote të tillë, ku janë shkrirë puna e madhe ndërtimtare me përmbyshjen e madhe në marrëdhëniet njerëzore, më saktë, me vendosjen e tyre mbi baza të shëndosha barazie dhe ndërsjellësie.

(Sot lidhja e një djali dhe e një vajze është diçka e përkohshme, e perceptitë, e kushtëzuar kryesisht nga elementet e interesave të rëndomta. Dhe shpesh e shoqëruar me

doza të forta agresiviteti, deri në vrasje. E dhunshme shoqëria, e dhunshme jeta, të dhunshme edhe marrëdhëniet dashurore.) E, pra, atëherë ky ishte realiteti, realiteti i dritës dhe i dashurisë. Të dyja të mbrojtura, të përkrahura dhe të zhvilluara nga e gjithë shoqëria, nga i gjithë aparati i shtetit. Këtu kishte rolin e tij, madje detyrën e tij, edhe poeti. Kur u shkrua poema, D. Agolli ishte pak më shumë se tridhjetëvjeçar. Ndërsa hidrocentralet i Shkopetit, i nisur 14 vjet pas mbarimit të luftës dhe çlirimit të vendit dhe një vit pas ngritjes së universitetit të parë, në një kohë kur Shqipëria e re kishte ende probleme të mëdha e të gjithanshme duke filluar nga sigurimi i bukës, probleme të mbetura pa zgjidhur për shkak të prapambetjes së jashtëzakonshme shumëshekullore, ky hidrocentral në luginën e Matit, u ngrit brenda katër vjetësh!

Sa e njeh brezi i sotëm këtë histori? Një pedagog i vjetër më thoshte pak kohë më parë se brezi i sotëm e njeh historinë e vendit vetëm nga viti 1992 e këtej.

Sa e di brezi i sotëm se ç’do të thotë errësi shumëshekullore? Në janar të vitit 2003 më ka qëlluar të hyj në një qytet verior të pllakosur nga errësira. Një pamje tronditëse!

Ja, pra, se ç’mesazhe na jep, po të lexohet me pak vëmendje, poema “Dashuri dhe ferrobeton”. Është historia jonë e parë me sytë dhe e përshkruar me talentin e një shqiptari të ndershëm.

Ku ishim? Dhe ku jemi?

Ku ishim dhe ku jemi!

16.

“Poemë malore” (1962) është poema tjetër e Dritëro Agollit. Poema e dytë e krijuar brenda një viti! Sot ne e kemi të vështirë të përfytyrojmë se si lind idea e një poeme në mendjen e një poeti, si mbushet kjo ide me një varg idesh të tjera, si ngjallen përjetimet nga çdo ide e nga çdo mendim, pas parashkrimit të çdo ideje e të çdo mendimi. Dhe të mos harrojmë që sot nuk shkruan më kush poema. Jo vetëm te ne! Madje ka rrethe të caktuara politike, letrare e artistike, ku flitet e shkruhet hapur për vdekjen e artit, ashtu si flitet e shkruhet hapur edhe për vdekjen e familjes, vdekjen e etikës, vdekjen e shteteve kombëtare!

Ja, si e përshkruan këtë proces të lindjes

së një poeme vetë poeti:

Më mori malli të ngjitem në mal,
Kjo nuk është diçka idilike.

Prapë trastën do marr

e do dal,

Ku kryet lot pisha epike.

I tillë jam.

Dua të udhëtoj përhera,

Të udhëtoj me gazetën në xhepa,

Me fletore shënimesh,

me dhjetë cigare “Rivi-

era”

Brigjeve me pisha,

lugjeve me plepa.

Vetiu vjen në mendje fakti që sot njerëzit jo më që nuk kanë mall (përveç që mundësi!) të ngjiten maleve, pale më të marrin me vete një fletore shënimesh, por po i braktisin gjithnjë e më shumë zonat malore të atdheut. Thirrja poetike e D. Agollit ndoshta tingëllon për brezin e sotëm jashtë kohe, jashtë çdo arsyeje jetësore. Sikurse edhe të tilla vargje:

A u mërztien

shqiptarëve malet?

.....



Djepin etërit na e gdhendën nga boriga
Dhe gjyshtërit me legjenda në gjumë na
vunë,

Prandaj nuk shkëputemi nga romantika,

Megjithëse flokët brymë të bardhë na
zunë.

Romantikë? Po a i ka mbetur vallë sot, në epokën e triumfit të kultit të parasë dhe fitimit, ndonjë domethënie kësaj fjalë? E kujt i flasin vallë malet tona gjysmë të preta e gjysmë të djegura nga zjarret (jo rastësore!) e përvitshme? Ose Dritëro Agolli ka mbetur pas në kohë ose brezi i sotëm është kthyer aq pas në kohë, sa nuk ia rrok as mendja. Lexuesi le ta ndajë vetë këtë mëdyshje. Ndoshta do të kuptojë shkaqet e thella, që kanë sjellë dukurinë e braktisjes së zonave malore.

Le ta dëgjojmë edhe pak romantikën e poetit për malet:

Male shqiptare,

enigmë shqiptare,

Me shpella e lugje përposh,

nga malli për ju,

që digjte si zjarrri,

Naimi u bë tuberkuloz.

Në rast se lexuesit e sotëm nuk do t’i ndienin thellë-thellë këto vargje, në rast se madje do të shtrembëronin buzët apo do të gogësinin, do të duhej të prananim se në historinë e popullit tonë ka ndodhur një thyerje e rëndë (thyerje dhe jo kthesë!). Duam s’duam ne, poema e D. Agollit shtron për mendjen tonë një tjetër udhëkryq, na vë përsëri në mëdyshje: të përcaktojmë nëse jemi në udhë të drejtë apo në udhë të gabuar. Dhe më tej: nëse varet gjë nga ne apo jemi në një rrugëtim të detyrueshëm, në të cilin dikur, po ta kemi parasysh mirë, hymë me këmbët tona.

Të tilla janë poemat e D. Agollit: nuk na lënë të flemë gjumë rehat, të gogësitim duke hequr dorë nga çdo e vrrarë e mendjes. Ne duhet të vendosim: ta lexojmë këtë poet, këtë shkrimtar, apo ta lëmë të pluhuroset në raftet e bibliotekave dhe të nxitojmë në kafene për muhabet (e ç’i ka mbetur tjetër banorit të sotëm???)

Dhe ja një tjetër ide e spikatur e kësaj poeme malore:

LIBËR

Leximet maratonë dhe të ftuarit e “Tirana Lexon 2017” kanë qenë në kafe-libraritë dhe qendrat kulturore: “Salla gjermane e leximit, Biblioteka Kombëtare”, “Friend’s Book House”, “Hemingway”, “Destil”, Biblioteka Kamëz, gjimnazet “Çajupi”, “P. N. Luarasi”, “Sami Frashëri”, gjimnazi Vorë...

“Tirana Lexon 2017”, sërish në këtë vit

Me një përpjekje, që duhet konsideruar e mirë, Tirana pati sërish ngjarjen që në këtë vit u njoh si #TiranaLexon2017. Ai përbën një projekt të IDMC-Institutit për Demokraci, Media dhe Kulturë në partneritet me Bashkinë e Tiranës, që po kthehet në një traditë të bukur në qytet. Duhet thënë se ai është shtrirë në disa mjedise kulturore të krugjetit, ku personalitete të ndryshme, dashamirës të librit dhe shkrimtarë e përkthyes të njohur

shqiptarë, lexuan pjesë nga librat e tyre të preferuar, por edhe përcollën emocionet gjatë procesit së të shkruarit...
 Interessant ishte mënyra sesi ishin ftuar pjesëmarrësit, ku janë shfrytëzuar rrjetet sociale, me anë të të cilave publiku është informuar për të gjitha aktivitetet dhe ku të ftuarit lexuan pjesë të zgjedhura sipas dëshirës. Në median online pati njoftime, harta me vendet dhe oraret ku dhe kur do të zhvilloheshin leximet. Maratona e leximit është përshëndetur



nga artistë e personazhe të njohur të ekranit shqiptar. Ata dhanë mesazhet e tyre dhe thirrje që brezi i ri të lexojë më shumë, në një kohë kur teknologjia ka ndryshuar jo vetëm mënyrën se si jetojmë dhe punojmë, por edhe se çfarë lexojmë. Për ta bërë sa më të aksesueshëm nga publiku i gjerë, leximet janë zhvilluar në ambiente publike, kafe letrare, biblioteka etj.
 Leximet maratonë dhe të ftuarit kanë qenë në kafe-libraritë dhe qendrat kulturore: “Salla gjermane e leximit, Biblioteka Kombëtare”, “Friend’s Book House”, “Hemingway”, “Destil”, Biblioteka Kamëz, Gjimnazet “Çajupi”, “P. N. Luarasi”, “Sami Frashëri”, Gjimnazi Vorë.

#TiranaLexon2017 synon ta kthejë leximin në një ngjarje dhe nga viti në vit bën aktivitetet në hapësira të ndryshme, si edhe do ndikojë në përhapjen e një fryme sa më dashamirëse ndaj letërsisë dhe procesit të leximit si një ndër hapat më të rëndësishëm të funksionimit të letërsisë. (Burimi Express)

Po, shumë duhet të bësh,
 fisi im,
 Që truallit mos flesh, që gjizë mos hash,
 Kullave dritë t’u vësh me guxim,
 Të zhdukësh turqizëmën
 “javash-javash!”
 Unë e di,
 fisi im,
 ti ende jeton vështirë
 Dhe jeta s’të jepet si beze e lirë.
 Po ti, fisi im, ke muskuj të fortë,
 Muskuj,
 që malet mund t’i lëvizësh,
 Muskuj,
 që sipër çdo porte
 Dinë të vënë kurorën e dritës...

Ku është këtu lustrimi i realitetit, sikurse shkruhet e thuhet rëndom sot? Kush nuk e vë re këtu realizmin e përshkrimit të një realiteti të vështirë dhe realizmin e ëndërrimit? Thotë një fjalë e urtë: “I verbër nuk është ai që nuk sheh, por ai që nuk dëshiron të shohë”. A shikojë sot shqiptarët? Dhe, nëse po, a shohin, a dallojnë gjë?

17.
 Kohë më vonë, sikurse do ta shohim edhe më poshtë, Dritëro Agolli do të thotë se “poezia e një poeti është biografia e tij”. Poema “Devoll, Devoll” (1964) është një kapitull i madh i jetëshkrimit artistik e botëkuptimor të qytetarit dhe krijuesit D. Agolli. Këtu për herë të parë në mënyrë të plotë dhe të qartë janë shpalosur e shtjelluar dy temat e mëdha të të gjithë veprës së tij, të të gjithë jetës së tij: e para, dashuria për atdheun, e shprehur nëpërmjet mallit për të dhe dëshirës së bekuar për punën ndërtuese; e dyta, ideali i shoqërisë së drejtësisë dhe barazisë qytetare.

Radhicitjen e këtyre dy temave në krijimtarinë e Dritëro Agollit e bëri vetë jeta e tij, me ashpërsinë dhe bukurinë e saj, me bregat e mëdha dhe gëzimet edhe më të mëdha. Janë bregat dhe gëzime jo thjesht vetjake. Janë bregat dhe gëzime të identitetit të tij si shqiptar dhe si qytetar, bregat dhe gëzime të përjetuara thellë dhe të mbrujtura me një ndjenjë të pastër e të shtruar, por asnjëherë të shuar, krenarie.

Ja të dy temat e mëdha të jetës së D. Agollit. T’i shohim e t’i rikujtojmë pa mekinitet:

Po, Devoll,
 i tillë qenkam unë,
 Paskam marrë baltën tënde arave,
 Në një trastë leshi
 ndënë gumë,
 për t’ia sjellë
 Lidhjes së Shkrimtarëve.
 Nuk e di
 se ç’dreq poet më bëri

balta jote, bari yt i dendur.
 Unë jam një plisi yt i tëri
 Dhe një copë shkëmb
 i pagdhendur.
 Dhe ky plis
 ngaherë ish i fortë:
 shkoi n’Evropë,
 brodi në Azi,
 po kudo,
 nga flokët
 gjer në thonjtë
 mbeti devolli...
 Unë shpesh,
 Devoll, nuk jam i qetë
 Unë shpesh,
 Devoll,
 jam i pagjumë.
 Shqetësimet m’i ke dhënë vetë,
 Kur më bëre nga kjo baltë e murrme.
 Jam njeri i fortë,
 i pagjumë
 dhe çdo tingull kap,
 çdo tingull gjuaj;
 dhembje njerëzore
 kur ndjej unë,
 sentimentalizëm nuk e quaj...
 Ndaj unë komunisti nga Devolli,
 Që kam pendë,
 letër edhe armë,
 që hedh firmën:
 “Dritëro Agolli”,
 Ngrihem,
 kur kap tingullin:
 “alarm!”

Në shënjestër prap’ më kanë vënë
 Snajperët e shquar përtej deteve.
 Unë s’dridhem,
 unë s’e ul zënë,
 mbetem komunist për jet’ të jetëve...
 Thellë kësaj balte
 përmbi lumë,
 që aq breza rrënjësh e lëvrinë,
 unë,
 devolliu i pagjumë,
 gjeta vargjet,
 gjeta poezinë.

Sikur edhe vetëm me këtë poemë ta kishte mbyllur D. Agolli krijimin e poemave, madje gjithë krijimtarinë e tij letrare, prapë do të kishte mbetur Poeti i tokës shqiptare, Poeti i popullit shqiptar, Poeti i idealit të drejtësisë shoqërore në atdhe.

Dhe në këtë rrafsh e në këtë këndvështrim ai është i vetmi. Nëse në të ardhmen shqiptarët do ta ruajnë vlerën e këtij krijuesi, atëherë kjo do të ndodhë duke ruajtur para së gjithash e mbi gjithçka krijimtarinë e tij më tipike, krijimtarinë e tij më të spikatur e më të shënuar. Pa poemat Dritëro Agolli nuk është më ai. Është i madh dhe i vyer, por jo më ai.

Vijon

Po thuaj të plota veprat e udhëheqësit komunist dhe të udhëheqësve të tjerë të Partisë së Punës mund t’i gesh rëndom nëpër kafe dhe vende prehje, ku për hir të së vërtetës, shqiptarët kalojnë shumë e shumë kohë. Imazhi komunist po zë vend të përhershëm në gjithnjë e më shumë klube dhe duket se një identitet i ri urban kërkon që ta gërshetojë imazhin e të shkuarës me atë të sotmin...

A po rilind ndryshe nostalgjia për komunizmin?!

NGA BEN ANDONI

Ka një prirje të re në mënyrën sesi njerëz it e kohës së sotme po e përshfaqin nostalgjinë e tyre ndaj komunizmit. Ajo lidhet me prijatë e pavullnetshme të shumë të rinjve, që imazhi komunist u duket tërheqës për shpalosjen e ideve të tyre ose shites së produkteve; biznesit dhe mënyrën sesi e përshfaq simbolikën; dekorimet e mjediseve për të sjellë atë kohë; mënyra e përcjelljes në vepra arti identitare; ose dhe qoftë thjesht për ta përdorur si element turizmi. Por, më e frikshme nga të gjitha, duket se është ajo që bëhet kine dhe rri veshur nën petkun e një shikimi racional të gjërave.

Po thuaj të plota veprat e udhëheqësit komunist dhe të udhëheqësve të tjerë të Partisë së Punës mund t’i gesh rëndom nëpër kafe dhe vende prehje, ku për hir të së vërtetës, shqiptarët kalojnë shumë e shumë kohë. Imazhi komunist po zë vend të përhershëm në gjithnjë e më shumë klube dhe duket se një identitet i ri urban kërkon që ta gërshetojë imazhin e të shkuarës me atë të sotmin.

Idetë për ushqim më të mirë, për drejtësinë e duhur të asaj kohe dhe një lloj morali shumë të lartë, barazinë e gjerë, i errësojnë gjykimet e njerëzve për një sistem që gjithnjë e më shumë u largua nga problematikat e njerëzve dhe tashmë i ka humbur gjurmët reale.

Por frika më e madhe ishte dhe erdhi pas publikimit të sondazhit të OSBE-së për të kaluarën komuniste në Shqipëri, ku në disa zëra të pyetësorit dukej një fryrje e kujtesës nostalgjike për komunizmin.

Mendojmë se përcjellja e shumë emrave të zakonshëm apo akronimeve urbane të asaj kohe është fare normal në kohët moderne. Ato kujtojnë jetën sociale të shumë njerëzve, por edhe socializmin e publikut në atë kohë. Aman është tejet i tepruar përdorimi i sloganeve të komunizmit dhe gjoja përshatja me teprë thjesht për raste përfitim. Vetëm të kujtoshet parullat ende të mbetura të pafshira në Spaç e kujton sa e hidhur tingëllon për kurrizin e shumë njerëzve, që u masakruan në atë kohë.

Në këtë shtjellë të argumentit nuk përfshijmë asfare nostalgjikët e çartur që në çdo aktivitet ekspozojnë figurën e Enver Hoxhës



me fotot, pankartat dhe deklamimet në publik. Këta nostalgjikë janë kaq të dalë mode saqë u ka mbetur në hise vetëm shpottija...

Është e kuptueshme që shoqëria ku jetojmë meriton kritika dhe madje ato tejet të ashpra. Dhe, janë qesharakë ata, që e përmendin atë regjim me aq adhurim. Por, duke përfshirë jo fjalë për fjalë Çërcillin, se ne të gjithë e dimë që kapitalizmi s’është sistemi më i mirë, por më i përshtatshmi me kohën, atëherë na lind dëshira për t’i thënë gjërta si duhet: Edhe pse me shumë zhgënjim prej të sotmes, nostalgjia për kohën e Enver Hoxhës është një përqeshje e hidhur me alternativat e munguara që ajo kohë dha për shqiptarët duke e identifikuar vendin asokohe në një kampione të vërtetë të shkeljes së të drejtave të njeriut.

Me shumë gjasë, zhgënjimin e kësaj kohe do ta zbusin historianët e të nesërme që do ta shikojnë më qetësisht, por edhe më me largpamësi jo vetëm figurën e diktatorit komunist por edhe gjithçka që u bë në atë kohë dhe që i lë ende të dyzuar shqiptarët.

Nëse shqiptarët vazhdojnë kështu dhe nostalgjia do të vijojë të rritet, atëherë mund të shikojmë në konstatimin e duhur të shkrimtarit tonë Kadare: “Muri i mbrojtjes së solidaritetit të së keqes, po ngrihet”, në Shqipëri. Dhe, kjo është realisht për të ardhur keq.

Mbase alarmi është i tepërt, por shqiptarët duhet të shikojnë shumë përpara dhe të lenë dashia e vogla apo t’i vendosin këmbët sërish në këpuccë e të shkuarës, mu ato që e mbajtën pas dhe e gdhinë në ndryshimet evropiane si një nga vendet më të varfra të Evropës.

T

TREGIM

NGA ROLAND GJOZA

Ishim ndarë thuajse përfundi misht. Ajo kishte qenë mikesha ime e orëve më të bukurra. Dhjetë vjet pa u parë. Unë larg në një qytet të perëndimit, ajo në Shqipëri, me një punë të mirë, shumë prona, një burrë të fisëm, me emër. Kishte një djalë dhe një vajzë. Të martuar, me fëmijë.

Tani më çonte dy mesazhe tronditës në Facebook që më lanë pa gjumë. O zot, si mund ta ndëshkosh njeriun tënd kaq rëndë. Dhe më erdhi të kujtoj atë shprehjen time, kur binte fjala për fëmijët: Dua të jenë mirë me shëndet. Kaq. Sa pak, dëgjoja përgjigjen e tjetrit, që s'më tundonte aspak për t'iu shpjeguar njëfarësoj.

Melania, kështu e quanin mikeshën time, sapo mbërritëm në qytetin e ëmbël lirik me liqen dhe male me dëborë, më kishte pëshpëritur: Të lutem mos më trokit sonte! E quajmë një trill timin, një marrëzi atë që ndodhi, të lutem... Po syri i madh me një grimë lot vezullues që i shkiste papritur në mollizat mongole, sikur më tundonte me një kumt të fshehtë... Gjithmonë zinte dhomë teke kur ishim bashkë me shërbim dhe unë i trokisja natën: Melani, jam unë... Po dera ishte e hapur dhe unë hyja. Do më marrësh më qafë, pëshpëriste dhe më bënte vend në shtrat, oh, që s'u njohëm kur ishim të rinj, po kaq vonë... Kam dy fëmijë të rritur dhe s'është aspak e hijshme... Më jepej menjëherë dhe dridhej në krahët e mi, krejt e pafuqishme për të më kundërshtuar. Më kashonte buzët dhe më pëshpëriste: Ti duhet të ishe imi... imi... o, ç'gjedhje të gabuara që bëjmë dhe tërë jetën luajmë komedi... shpirt, më më braktis... Po ti më thua, më harro, ia kthejta unë. Të them ashtu nga frika. Kam shumë frikë. Po të merret vesh, fëmijët, të parët, s'do të ma falnin.

Bënim dashuri deri në mëngjes dhe ajo ishte e mrekullueshme në shtrat. I dashur, duhet të dalim në mëngjes herët në breg të liqenit të presim peshkatarët e koranit... Në mëngjes, para se të dilnim, ashtu të përqaftuar në dritën e mekur të agut, më kashonte majën e veshit dhe me pëshpëriste: Edhe njëherë, para se të dalim... më duket sikur s'do ta bëjmë më kurrë, sikur një rrethanë do të na ndajë përgjithmonë... Dhe të mendosh se unë isha pesëdhjetë e dy dhe ajo dyzetë e tetë, të ndezur të dy rrejshëm më tepër prej moshës që po na përëndonte, s'na kishin hije shumë gjera, po në bënim sikur s'i vinim re. Shpirt, dalim tani...

Zbritëm poshtë dhe qëndruam në breg. Larg nesh në vijën e fundit të liqenit në atë blu të errët, kundruall malit me dëborë, që shkelqente me një dritë të marrtë, dukeshin barkat e peshkatarëve të koranit. Frynte akullion, kredharaku lëshonte vaj të thekshëm, llapashitje lopata në ujë, vejevinin tinguj të çuditshëm dhe

Një narracion nostalgjik i autorit, një nga rrëfimetarët e njohur të letërsisë sonë, ku ndërthuren shumë shtresëzime...



DREKË ME KORAN

ajo kthente kokën nga unë dhe më shikonte me një mall të egër... Ah, ti s'di gjë, sikur më thoshte me atë syrin e saj të madh. S'të kam treguar gjë, po...

Larg dukeshin dy barkat e para që po afroheshin, ajo bëri disa hapa drejt bregut.

Dy peshkatarë të përgjumur, shpërfillës, me sy të buhavitur, me mjekër e mustaqe të mëdha, ndaluan të këmbët e saj. Në sheshin e barkës dergeshin nja dymbëdhjetë koranë mbi njëkilësh, ndonjëri përpëlitej ende me gojën e hapur, në hjekë.

Melania ishte grua e bukur, me spikame të vijave sensuale, që të ndillnin. Njëri nga peshkatarët e vuri re, ia kaloi shikimin e përgjumur nga goja i bujshëm të kofshët e kërcyera përplot eph ngashënjes.

Mirë mëngjesi, tha ajo, kam dy ditë që ju pres... Ju lutem, më ndihmoni, më duhen nja katër kile koran... Ata nuk ia varën, nxorën barkën në kum dhe i peshuan kuzhinierëve të hoteleve dhe restoranteve, që erdhën menjëherë me një frymë: koran, belushk, lekl me një cmim të kripur. S'kishte më peshk në shesh, vetëm peshorja ende luhatej nën erën që u bë si e tërbuar. Ah, që s'kam fat! tha Melania. Po sot më duhen patjetër nja katër kile koran. Jam gati ta blej sa të më kërkoni pa bërë fare pazar. Zonjë, i tha ai që i kishte hedhur atë shikimin prej burri sevдали, kemi dhe për ty... koranin që gatuajmë për vete... Kemi një javë atje, zonjë, për këtë peshk të bekuar... po ia vlen... I mbështollti me gazetë pesë a gjashtë koranë të mëdhenj dhe ia zgjati pa ia peshuar. Sa kushton? pyeti Melania. Jepni sa të doni, zonjë, edhe po s'patët, s'ka gjë, se s'humbasim ndonjë gjë të madhe... Ju jeni mjekë e dëgjuar, keni ardhur për difteritin... a e dini se në spitalin ku shërbyet kaq ditë ishte shtruar dhe vajza ime? Ajo s'ju heq nga goja... Po sikur të mos me japësh asgjë? E lëmë kështu? Nuk dua para, e ç'do të më bëjnë mua ato? I prish

menjëherë, shkoj e pi... Shko zonjë e i ngrënj gëzuar me një verë të mirë buti! Dhe i ktheu kurrizin. Pastaj iku, pa e pritur tjetrin. Kishte një javë në liqen dhe po kthehej pa një kacidhe dhe pa një koran në shtëpi. Melania bëri hapa ta ndiqte, po peshkatarit tjetër e ndaloi: Mos, zonjë, se ai nuk kthen mendje... Atë kohë ra zilja e celularit të saj dhe Melania futi menjëherë dorën në xhep, e nxori atë me të shpejtë dhe e vuri menjëherë në vesh. Alo, shpirt i mamit, Valbona, ku je, nga po më merr... Kaq dëgjova, u struka nën strehën e një kioske dhe e prita. Fytyra iu gjallërua, qeshte, fshinte lotët me një melkje që i shkonte, trishitohej e pikëllohej fare befasishëm aq sa të dhimbjejë vërtet, lutej e përgjërohej e më në fund e mbylli celularin me një mbresë kënaqësie të ngrirë. Diçka nuk shkonte, ose ashtu më dukej mua... Më bëri shenjë që ta ndiqja dhe nxitoi hapat. Kishte një xhakëtim me vata që ia tregonte shpatullat të gjera, e cila i rrinte puthitur pas gjoksit, shpinës petë dhe belit, këllqet dhe kofshët e saj të shkateronin, pantallonat xhins, tejet të ngushta, ia nxirrnin me spikamë format e tyre tunduessa, le të kisha bërë seks me të tërë natën dhe në mëngjes herët, ai ndezulim i beftë i epshtit që të kaplonte vullshëm dhe ajo trulloste lektisësë, e fortë, dëshira e shturur për të bërë dashuri, më bënin sërish rob të saj. Ashtu kishte filluar, atje të pavijoni i kardiologisë kur kishte sjellë Bebin, të shoqin, një burrë simpatik që duhej t'i nënshtrohej një operacioni. Ishte një fërkim që ndodhi rastësisht, po që na bëri të rinjshëm. Ishim parë nëpër spital, po nuk kishim pasur rast të njëlshëm. Ishte një fërkim brutal, siç ndodh rëndom, kur pengohesh në një vend të ngushtë dhe ajo me nguli ato sytë e mëdhenj me një egërsim të pavetëdijshëm, po nuk u tërhoq, ashtu mbeti, gati e shembur në krahët e m'i, u zbut menjëherë, qeshi zëshëm me një sensualitet çmendës dhe më pëshpëriti: Më

jepni fjalën, doktor se operacioni do të dalë me sukses? 99 për qind, i thashë. Kush është ai 1 përqindësi që s'ju bindet? më pyeti. Ju! iu përgjigja dhe isha gati ta rrëmbeja në krahë, aq shumë dall-disa pas bukurisë së saj. Ajo shantangu nga përgjigja ime, nuk e priste që unë t'ia thosha kaq hapur. E bëra vetë operacionin dhe fytyra e saj, ajo aromë e gruas që është e veçantë të secila, depërtonte dhe aty në atë batërdi gjaku, mishrash të hapur, barnash, frymësh, djerse, më kapnin herëherë dridhja, një rrëqethje fund e majë si ethe me shkaktonte një ndjesi venitjeje, humbeje, shpërdarjeje nëpër etër, gati po rraskapitesha nga një mendim i ngulët, i çuditshëm, doja ta shtjira në dorë, ta bëja me atë femër. Kjo m'u kthye në fikcion. E njëjta gjë kishte ndodhur dhe me të, këtë e kuptova kur e ftova të bënim bashkë një shërbim jashtë dhe ajo nuk kundërshtoi. Atje, në një qytet nordik, me mëngjes me njëqull dhe lule, m'u dha menjëherë që natën e parë dhe gjithmonë ishte e gatshme kur i shqiptoja ndonjë dëshirë, për të bërë atë që doja unë, edhe për të pirë, edhe për të vallëzuar, edhe për të bredhur natën. Ishte një dashuri e çmendur. Kishim gjetur njëri-tjetrin, siç thonë. Nuk u ndamë më. Po ama të dy ishim të martuar dhe me famijë. Asnjëherë nuk bëmë biseda të rënda, kurrë nuk e përmendëm ndarjen, iken dikë, fillimin e një jete të re, sepse ajo i donte shumë fëmijët, marrëzisht, nuk mund të ndahej nga Bebi, që i bënte gjithë ato punë dhe ia kishte lehtësuar barrën e jetës, që e linte të lirë, e duket i kënaqur që i mjaftonte aq sa i mbetej. Po fëmijët ishin obsesioni i saj: një dhimbje e vërtetë, i donte me vuajtje, me çikërrima që ia zinin frymën. Valbona ra menjëherë në dashuri me Fordin në Amerikë dhe as i shkon mendja të ketë një dashnor. Volpi, djali, është i tmerrshëm, i pangopur me femëra. Po nuk ia kam frikën. Ka një grua shumë të bukur, apo jo, Ardi,

Belindën me nam. Po Valbonën e mora më qafë, kështu më është mbushur mendja, e çova në Amerikë kur s'i kishte mbushur të katërbëdhjetat, pastaj vazhdoi në Princeton për shkencat, master, PHD, gjeti një vend pune me 200 mijë dollarë në vit, takoi Fordin dhe ra në dashuri me të, ai bënte ç' i thoshte ajo, po unë e doja vajzën këtu, ia mbusha mendjen dhe ajo erdhi, zuri një punë me 10 mijë në vit, një apartament pa dritë, pa ujë, me vjehërr e vjehërr nëpër këmbë, me shumë privacione banale, aq sa u mërzit dhe më thoshte shpesh: Mami, dua të kthehem, s'e përballoj dot këtë jetë...

Këto m'i përsëriste shpesh. Pastaj më fliste për të vegjlit, të cilëve u kushtohej me një përkujdesje të sëmure. Me gjithë këto halle, ajo kishte mbetur krejt femër, pa një cen, një seks tronditës me një bukuritë të pjekur, pa freskinë e moshës, po me fshehtësinë e përvojave të rrezikshme, që me shumë të ngashënjëjnë. E mbante vetën, kishte shije të hollë për veshjet, bënte kujdes me ushqimin për të ruajtur linjat seksapile. Sa herë rrinim bashkë, ajo bëhej menjëherë graja e qejfit, sikur s'kishte lidhje të tjera, përveç lidhjes me mua. Gjithmonë me thoshte shpirt, s'ma përmendte emrin, veç rrallë, kur kishte për të më rrefyer diçka për problemet e saj familjare.

Ja, tani bridhte nëpër hotel për të gjetur akull. Kush mund t'i kundërshtonte asaj, kush mund të guxonte t'i thoshte ndonjë fjalë të pahijshme, si mund t'i rezistojë asaj fytyrë të bukur që ta ngeçte fjalën në grykë, atij kurmi të plotë, të hijshëm, që të dukej sikur ta jepte me dackë fytyrës prej ephshndjelljes? Erdhi vetë pronari, një ish futbollist i njohur dhe u mor me paketimin e koranit siç dinë ta bëjnë këtë punë sojlinjtë e vjetër të gotës.

Do të nisemi menjëherë, më tha ashtu nxitimthi, atë ditë të vijmë nesër për drekë!

Kishte një Lamborgini të re, që ia kishte dhuruar Bebi për ditëlindje, për të cilën vdiste. Zura vend në ndenjësë dhe u nisem pa ngrënë mëngjes.

Shpirt, ata do të vinë. Tani është halli që të më vijmë me gjithë fëmijët... Ja, bëri punë korani. Është vërtet peshk i rrallë, i thashë, ndodhet vetëm në Ohër dhe Bakjal. Dikur, në kohët e arta, ky peshk ishte dhuratë mbretërore. Ashtu?... Jam shumë e lumtur, s'jemi mbledhur bashkë që prej vitit të kaluar. O Zot, sa i dua!

Dhe qau. Melania ishte graja me e bukur në botë kur qante dhe unë i lija të derdhte lot dhe e puthja. Ajo qante shpesh se nuk e duronte vuajtjen. Ishte si të gjitha gratë, e palumtur, siç janë të gjithë meshkujt, të palumtur, por që hiqen të lumtur.

Si ikëm kështu papritur, i thashë. Kthehemi pasnesër që në

P

PERSONAZH

NGA BESIM FUSHA


Kur u shkëputëm nga "trungu..." dhe morëm për zyra me qera shëpinë e Speces... - në rr: "Budi" nr.3, në të "Pionierit" - nja 7 a 8 veta - sikur u ndjemë më të lirë... Mbase, edhe ngaqë, puna krijuese kryhet në zotshë në vetmi... larg shëfave dhe zhurmave... Gjetëm pra edhe mjedis të ri, veçanërisht kohëçlodhjeve: kafe ke Bulja apo Monda - dritë banaku... - vetshërbyes hileqar ne... për të zënë përballën... mbi tavolinat këmbëgjata, pa karrike... Apo... unë, edhe vetëm brenda xhamit të floktores, ku ulesha pa shokë dhe kqyrja lëvizjet e rrugës... nusët e reja pa fëmijë e me fëmijë për dorë... apo studentët kushëdinga, me libra në duar - si gocat turizëna nga celularët e sotme...

Tamam aty, mbase naivshëm... unë nuk e dija që kisha ra në "çarkun" e Seferit ngacamac. Seferi i qoshes matonë meje, pyeste vetëm për artin... Ietërsinë dhe poezinë. Sajohej edhe pa ditun... dhe unë, duke kujtuar se flisja para do dëgjuesve që s'dëgjinin ç'thoja... i mëshoja kot edhe me dashje, asisoj sa nuk habisja ask-

Robert Elsie i thash atij çasti se do të doja me shpirt të shpluhurosen edhe sirtaret e botës... - ç'thotë bota për Shqipërinë dhe shqiptarët e mi... Nuk i thash për fotografinë. Thjesht ngase nuk m'u kujtua. Nuk thash edhe se jam fotograf... Që të mburresha sot duke u krekosun se idenë për të shkundun edhe pluhurin e kushedisa sirtarëve me fotografi... - atë që në të vërtetë e bëri R. Elsie... - ia cyta unë... Jo. Njeriu i punës i gjënë vetë rrugët drejt saj.

Robert Elsie, gjermano-kanadezi që na mësoi se si shpluhurosen vlerat e përzëna

(29.06.1950-02.10.2017)



Robert Elsie

mrekulluar si kurrë... kur gjeta një të vërtetë... I cytun nga libri yt i madh... pyeta për Himën gjynofarë. Doli e vërtetë... që në sirtaret e Himës dhe Netes (Fitnetes), me mbiemrin Hasnaj, gjendeshin tri dorëshkrime të Himës... ose "Bardhyl Nizami-t"... ose "Cen Qytku-t"... Qenë zverdhun dorëshkrimet... edhe nga tetriri i sirtarëve: "Unë dhe ndjesitë e

mia" - 1939... "Reze të zjarra" - 1980... dhe "Lot skamnorësh" - 1940... Tani që nuk është Hima i shkretë... je Ti përgjegjëse për këto libra. Mbjafort e mirë këto vlera!...

- Jo! Ka çun Hima... - më tha Netja shpirtbujare... Do boj çmos ta gjej, ene ta flas ene me Çunin... - Çun Hima...?!

- Po... alamet çuni! Ka qenë i martu Hima, me itajlone. Kur Hima ra në burg, ene psoi telefonin 10-15 vjet - veç se qe me shpirt fetari... - italionia, s'di si e gjeti marifetin, ene hiku. Mori çunin ene hiku... Kështu më tha Netja e mirë. Unë - sesi u ngërca... Nuk e pyeta ma tutje... Sidosesi, sa për dorëshkrimet...(!) Ate që dinte vetëm Hima... dhe Netja - dhe se dinin tanë shqiptarët dhe as unë... ja the mbarë botës - Ti... nga Kanada. Ngecem për të gjetun lllafin e madh të përgëzimit... Do të mbeitem përherë i mahnitun për gjetjet... qoftë edhe preferenciale. Në veten time e kam qajqun enciklopedi adresive me vlera... - që ka ndrituar rrugët e qosheve drejt letërsisë shqiptare... Më duket një

mençuri kjo që, edhe tanë burrat e shkencës këtu, munt t' gjenin vlerat nën pluhurat e sirtarëve... por... Bravo Ty! Më duket madhështi pa çimim kjo puna jote... Ngjashëm po kështu, unë kam nanurisun ëndrra për të kundërtën... - se ç'vlera fshehin sirtaret e botës për Shqipërinë time... ***

Robert Elsie i thash atij çasti se do të doja me shpirt të shpluhurosen edhe sirtaret e botës... - ç'thotë bota për Shqipërinë dhe shqiptarët e mi... Nuk i thash për fotografinë. Thjesht ngase nuk m'u kujtua. Nuk thash edhe se jam fotograf... Që të mburresha sot duke u krekosun se idenë për të shkundun edhe pluhurin e kushedisa sirtarëve me fotografi... - ate që në të vërtetë e bëri R. Elsie... - ia cyta unë... Jo. Njeriu i punës i gjënë vetë rrugët drejt saj. Asocasti pra, ai vetëm nënqeshi, tundi lehtë kokën dhe heshtiti... Siç nuk bëjnë ndryshe njerëzit e punës... Për t'ia vjelun në të llafave vlerën e mundit...

mëngjes. Po nuk e dëgjove ti, Ardi, nuk e dëgjove, shpirt, më mori Valbona, me pyeti për peshkun dhe unë i thash se e gjeta dhe ajo më tha se do të vij në nesër për drekë. E kupton ti apo s'e kupton. Drekën e nesërme e ndërroj vetëm me vdekjen time, aq vlerë ka. Do të më vijë. Po sikur t'ia dalë ndonjë punë, se të vetmit janë... Jo, o Zot, po Volpi i mamit s'ma kthen fjalën, i bëra be për kokën time... Ç'thish, Ardi, po s'më erdhën, jo, jo, ç'them kështu? Jam me e lumtura në botë!

Më la dhe iku. E gjithë kjo se si m'u duk. Pothuaj nuk e kuptova Melaninë. Pastaj erdhi ai rasti kur m'u bë oferta nga një spital privat në Bavari dhe vendosa të shkoj. E kisha të vështirë të ndahesha me Melaninë, po punët kishin kohë që s'po më ecnin. Kisha mbetur një kirurg varfanjak. Nuk merrja para, ja kjo ishte çështja. Sa herë më takonte të bëja operacione, kolegët e kishin të qartë që s'do të merrnin asnjë kacidhe nga pacienti, prej shkakut tim. Po mafia është dhe aty ku zemra nxirret nga kraharori për të prerë venën e bllokuar, ajo di të gjejë rrugët që ajo zemër e dashurisë të ketë dhe një xhep për para, se ndryshe, mund të ndodhë hataja.

Nuk mund të largohesha pa u takuar me Melaninë. Ishte një natë me shi. Shurukama e tubave të ujit, brerimi nëpër dritat e fenerëve, që merrte ngjyra blu dhe vjollcë, sikur binin dhe lule, përplaseshin në dritaren e madhe të klubit ku po e prisja. Ajo erdhi, e lagur qullë, me një çadër të vogël, që s'e kishte mbrojtur dot. U ul

përballë meje duke shkundur flokët e mëdhenj që i rrezëllin në dritë prej piklave të shiut si mijëra gjiçpëra që dukej se po i endnin një aureole, aq e bukur dukej. E dija që po e humbja. Po dhe dashuritë, sado të mëdha të jenë, vjen një kohë dhe lodhen, rraskapiten prej përsëritjes. Ndoshta ishte fundi ynë. Edhe për një shkak, se Melania tani ishte bërë me një spital privat, kishte dy vlla, njërin në Jale dhe tjetrin në gjirin e Lalzit. Se fundi, Bebi kishte blerë dhe një jaht. Ata udhëtonin me shoqërinë nëpër Mesdhe. Takimet tona ishin bërë më të rralla.

O, shpirt, po shkon të bëhesh i famshëm? Edhe ti po më le, ti, i fundit...

Nuk ia vura veshin fjalëve të saj. Ia shpjegova njëfarësoj shkaqet që më shtynin të largohesha.

Unë e shkreta kujtoja se e kisha një ishull të harruar në jetën time. Sa herë të paraqitej nevoja të shkoja në atë ishull. Një ishull në oqeanin e vetmisë.

Ç'flet! i thashë, paske filluar të lexosh romane sentimentale... Jo, s'lexoj dot, s'kam kohë... Po sikur të mos shkosh?

E pse të mos shkoj? Sepse të dua këtu. Kam nevojë për ty.

Edhe unë kam nevojë për vetën time, i thashë.

Harroje.

Nuk mundem.

Të mbaj unë.

Dua të punoj, Melani. Të bëj atë punë që di. Ta nxjerr paranë qërtësisht prej një punë që ka arsyen e

shëndoshë që të paguhet.

Të njoh. Siç njoh fëmijët e mi. Ah, ajo dreke me koran. Pse ma përmend?

Që prej asaj kohë nuk jemi mbledhur me. Tani po me ikën dhe ti. Po sikur të vij herë pas herë atje dhe të bëjmë dashuri? Kur të duash, i thashë, edhe unë do ta ndjej shumë mungesën tënde.

Do të vij patjetër, shpirt.

Me zgjati një pako me dollarë. Ishin mbështjelle keq dhe dukeshin.

Në fillim do ta kesh të vështirë. Të lutem, s'gjeta një mënyrë tjetër për të me kujtuar njëfarë kohë. Mos m'i kthe. E di që s'pranon. Mirë, e lëmë të m'i japesh kur të kesh.

Ia mora. Nuk mund të grindesha me të. Fundja, do t'ia ktheja një ditë. Ajo nuk erdhi. Kaluan vite. Dhe mesazhet në Facebook u rralluan se tepërmi. I ka punët mirë, mendoja me një fije melankolie dhe me një dëshirë për vëlue se për ta pasur si dikur, tani ajo është një borgjeze vanitoze, mendoja dhe qeshja, se e dija që s'thosh plotësisht të vërtetën.

Ja, tani këto dy mesazhe. I pari: Shpirt, po të shqetësoj, po s'kam njëri tjetër, kaq të afërt, që t'i hapem: Volpi u nda me gruan. Ajo fitoi me gjyq fëmijët, pra, ata pothuajse s'i kam me. Volpi ka ndryshuar, nuk është më ai i asaj drekës me koran, që u përmbajtë premtimit dhe erdhi. Ah, si e kemi kaluar! U bëmë si budallenj, unë dhe Bebi, këpusimim gafa të forta dhe ata sikur u zhgënjyen prej

nesh. E kishim nga dashuria e madhe. Po e kishim dhe prej vajtjes që midis nesh ishte hapur një hendek i madh. Volpi, ai zuzar i paskrupullit, ka ndarë një grua me tre fëmijë nga burri dhe ka venë kurorë me të... ku, do të thuash ti, në Los Anxhelos. Dhe atje janë akoma. I ka bërë naftën punë. E mbaj unë me para. E vetmja gjë që me lidh drejtpërdrejt me të është se ia dëgjoj zërin e dashur në celular dhe me mbysin ngashërimet. Po ama, ia dëgjoj zërin. Ma ka bërë plage zemrën ai djalë. E kishte yll gruan e parë, Belindën, ra në dashuri si i çmendur pas saj, e gjeja kaq herë të ulur në gjunjë para saj, aq shumë e donte. Po paskësh qenë Don Zhuan. Me fal, shpirt, që të mërzis me këto hallet e mia... Të uroj suksese, kam marrë vesh se je bërë kirurg primar dhe të duan. I lutem zotit për ty!

Të puth Melania.

Mesazhi i dytë: ... Më është neveritur jeta, prej fatqesive që me kanë renë në kokë. Valbona, bija ime e mirë, që unë mizorja e solla nga Amerika në Shqipëri prej egoizmit tim, se doja ta kisha - unen te dera e shtëpisë dhe ta shikoja përditë, sapo ka bërë ndërhyrjen e dytë në Nju Jork. Kancer të avancuar në gji. Ç'i thua kësaj, a ka ndonjë nënë tjetër që të ndëshkohet kaq rëndë? Tani i ka mbetur zotit të bëjë diçka për të. Prandaj s'kam ardhur të të takoj. Ç'të vi, hallet më kanë plakur. S'jam me ajo e para. Jam tretur, kockë e lëkurë jam bërë prej upës. Ai, i shoqi, është ca shpërfillës, kështu me duket,

kushedi mendon për tjetrën... fëmijët e gjorë... të vegjlit... sa pa fat! Shoh Valbonën si humbet në peshë, si i bien flokët, i fikët zëri, humbet ekuilibrin, ka dhembe që s'i bëjnë efekt ilaçet... jam një dëshmitare e fëmijës që po vdes! Dhe s'bëj dot asgjë. Ja, ç'jam! Mëshirë, o zot, bëje mrekullinë! Kjo me ka mbetur e fundit: lutja! Lutu dhe ti, shpirt, për mua, ti, i vetmi që kam dashuruar në këtë jetë! Jam shumë e mërzitur. Nuk dita të bëj familje. Jo, nuk dashë shumë dashuri, ndonëse kujtoja se jepja. Nuk dashë shumë kohë për ta. Isha egoiste. Ndoshta fëmijët na vranë, ndoshta i vramë në fëmijët. Familjet pa dashuri me mirë të zhduken! Të kujtohet tërë jetën, si gjënë me të bukur, atë drekë me koran... Kjo është shumë e hidhur, kaq deziluzionuese...

Melania vdiq në duart e mia. Erdhi më në fund tek unë, pas vdekjes së Valbonës dhe arratisë së Volpit, e sëmure nga zemra, e shtrava menjëherë në sallë dhe më mbeti në duar. Kisha vranë dashuri në time, të vetmen dashuri. Vetëm me të s'kisha qenë i zoti. Vetëm me të. Sepse ajo mund të shpëtonte. Dhe në të dy mund të kishim kaluar disa netë bavareze në alpe ku unë shkoja shpesh për ski dhe në shtëpinë prej druri që kërcente të kishim bërë dashuri pranë zjarrit të ushqyer me dru në oxhakun prej tullë të kuqe, ndonëse e dija që s'do ta kishte magjinë e asaj kockë të largët, të drekës me koran. I kishim pasur dhe i kishim humbur gjerat me të bukura, ndoshta prej fajit tonë.

Nju Jork, 2011

A

ARGUMENT

Gašper Malej, një përkthyes dhe poet slloven në "POETIKA - Tirana in Between" 2017

Rezidencë europiane për shkrimtarë dhe përkthyes letrarë

Gjatë muajit shtator, mik në Rezidencën letrare "POETIKA Tirana in Between" ishte përkthyesi dhe poeti slloven Gašper Malej. Kjo rezidencë, që fton shkrimtarë dhe përkthyes letrarë nga rajoni dhe Europa, organizohet prej pesë vjetësh nga Poeteka me mbështetjen e rrjetit europian për letërsinë dhe librat TRADUKI, Ministrisë së Kulturës, Ambasada të Gjermanisë, Austrisë dhe partnerëve të tjerë vendas.

Gašper Malej lindi në vitin 1975, në Koper, Slloveni, qytet ku dhe jeton e punon. Në vitet 2004 dhe 2009 ai botoi dy librat e parë në gjuhën sllovene: *Otok, slutnje, poljub* (Ishull, paralajmërim, një puthje) u propozua për çmimin e "Librit të parë më të mirë në Slloveni". Pas tij erdhi libri *Rezi v zlatem*, ndërkohë që gjatë vitit 2017 ai ka bërë gati për botim edhe librin e tij të tretë me titull *Pod to celino*

(Nën këtë kontinent).

Poezia e Gašper Malej u përkthye që herët dhe me përhapje të gjerë, në njëzet gjuhë të huaja, duke u përfshirë në disa prej antologjive të botuara në Slloveni dhe jashtë saj. Falë kësaj njohjeje ai u ftua të merrte pjesë në shumë festivale letrare në Europë dhe në botë, mes të tjerësh në festivalin e Poezisë në Pekin, në Nikaragua apo në Kolumbi. Ai është ftuar të bashkëpunojë gjithashtu edhe në atelie të shumta për poetë dhe përkthyes letrarë, ku ushtrohen teknikat e shkrimit krijues dhe të përkthimit letrar.

Për krijimtarinë e tij Gašper Malej është vlerësuar shpesh me çmime. Në vitin 2008 ai u nderua me Grantin e Ministrisë së Kulturës së Sllovenisë "Për autorë të shkëlqyeshëm të letërsisë", çmim

ky që në vitin 2016 vijoi me Grantin e Agjencisë Sllovene të Librit (JAK) "Për autorë të shkëlqyeshëm të letërsisë". Po ashtu edhe në vitet 2007, 2010 dhe 2015 ai u nderua me çmime e grante pune nga Organizata Sllovene e Përkthyesve Letrarë. Për meritat e punës së tij si përkthyes, në vitin 2011 Gašper Malej u nderua me çmimin prestigjioz "Zogu i Artë" për përkthimin e romanit P. P. Pasolini-t "Petrolio". Në vitin 2016 atij iu dha edhe një çmim i veçantë kombëtar për përkthim, akorduar nga Ministria Italiane e Kulturës dhe Turizmit.

Përveç çmimeve dhe nderimeve letrare, në vitet 2013 dhe 2016 Gašper Malej fitoi bursën për qëndrim nëmujor në Ventspils (Letoni) si autor në Rezidencën për Shkrimtarë dhe Përkthyes. Në qer-

shor të vitit 2015 ai ishte i fuar në Rezidencën e Shkrimtarëve në Vjenë, mbështetur nga Ministria Sllovene e Kulturës dhe në dhjetor të vitit 2016 ai fitoi të drejtën për të qëndruar në rezidencë pranë Qendrës Baltike për Shkrimtarë dhe Përkthyes (Visby, Suedi).

Pas krijimtarisë poetike, vepërimaria kryesore e Gašper Malej është përkthimi i fiction dhe non-fiction bashkëkohor italian, ku përfshihet poezia, narrative, drama, esetë etj. Bibliografia e përkthimeve të tij nga gjuha italiane në atë sllovene është mjaft e pasur dhe përfshin rreth 30 libra të zhanreve të ndryshme. Krahas këtyre janë edhe mbi 150 përkthime të shkrimtarëve sllovenë, të cilët janë botuar në revista letrare, në gaze-

ta si dhe janë lexuar në Radion Kombëtare. Ai ka përkthyer edhe pjesë për teatër.

Gašper Malej është gjithashtu një nga anëtarët-themelues dhe, prej vitit 2009, është edhe kryetar e redaktor ekzekutiv i KUD AAC Zrakogled - një shoqatë kulturore jofitimprurëse me qëndër në Koper, e cila që nga viti 2011 boton serinë "Helia", kushtuar përkthimit të librave fiction të autorëve bashkëkohorë të Mesdheut, të tillë si D. Drndia, N. Milani, F. Ebejer, Z. Zateli, JJ Millas, J. Nikolaidis, D. Velikiq, N. Fabio.

Ndër autorët italianë të përkthyer prej Gašper Malej përmenden Dino Campana, Cesare Pavese, P.P. Pasolini, Paolo Ruffilli, F. T. Marinetti, Dario Fo, Antonio Tabucchi etj.

NGA GAŠPER MALEJ*

Si një flutur e heshtur, që në boshllëkun e erës prert rrëshqitjen e hijeve të çlirohet nga përfytyrimet e mendjes dhe mbretëritë e tokës. Ke filluar t'i theksosh limitet; në përplasjen e kraheve të saj zbërthen arratisjen e botës, që as nuk i prek tregtarë, argjendarët dhe profetët që betohen në histori. Zëri yt është më i qashtë si grija e gurëve të çmuar dhe peliçeve me shkëlqim: siç mulliri i reziston tundimit të zjarrit të tij. Në flatrimin e një fluturë lekundet dhe ulet qetë.

Në çastet e heshtjes më të thellë je i ftohtë, magjepsës si një sirenë. Pasi fërkon mirë dyshemenë, dhe me përkushtimin t'i bësh pjjat të shkëlqejnë, mund t'i kushtosh poezisë. Këto fjalë të vënë në mëdyshje. Provon me një karficë të vogël, me një gjilpërë, me kalin prej druri të një fëmijërie të pajtuar. Provon sërish, e pastaj sërish. Durimit i erdhni fundi. S'mund të arratisesh më: emrat shkollë e vijnë. Herët a vonë do të bien në paqe, ndoshta pak më shumë objekte boshe.

I lodhur nga pritja, I lodhur nga zërat brenda nesh dhe hapat që ja mohojmë ekzistencën. Me dëshirën e përjetshme për të qenë e nesërmja. Ose dikush tjetër, vetëm një qepallë që hap këndin



Pa emër

e shikimit. Atje lart, përtej horizontit dhe të paprekshmes, shenjat e së cilës kthehen në të huaja. Në dilemë. Duke pritur që të ndodhë një tjetër shpërthim, zbulojmë përgjigjen; duke pritur që qielli me vje të hapet - e jo të shpërndahet - ku të mund të prehem të qetë, si mbi një qilim persian.

Puls i pandjeshëm: si lidhesh me farkëtimin e fjalës, duke e tërhequr

në një largësi që e shformon, sqfuar me baltë mbi diagramën e mpirë.

Sa shumë peshojnë, peshojnë, peshojnë kocka: dhe sa e pandjeshme je kur vjen në shtrat, përmbys prej ankthit. Të shtyp me zell: me dridhje kristalesh të bëj thirrje prej vetëdijes sime. *Atalanta fugiens*; nuk e di përse, nuk e di nga ku. Sërish hiri i kujtimit të pavullnetshëm që zgjon një koncept të paprekshëm, të huaj, që e mbaj parasjash: që më push-ton teksa hap krahet në një fluturim

të heshtur, i shënduar për të duruar, të pazabulueshmit ligje të rënies.

githnjë e më pak i përsosur, duke e njohur gjithnjë e më shumë, veten do ta përkufizoja me fjalën - me halucinacione: si gjurmët e fshehura në pikën e takimit, vigilent si një kafshë, i gatshëm për t'u bërë i padukshëm, një tog heshtjesh fatale. I destinuar për një mallkimi që jeton diku tjetër: kjo, sepse, çështje pa zgjidhje, parabola lakohet dhe zbrit në zbrazëtitë: atje ku unë e ndjek, e ku nuk mund të më mbërrish aq thjesht, vetëm me një përqafim,

marr përposht. Humrë zbritje e padurueshme. Për këtë po të flas.

Diçka po ndodh përmes gjetshes. Dhe ndoshta një pranverë ndryshe mund të mbush hapësirat boshe me zëra që nuk i përkasin qetësisë. Dhe do të dëgjohej jehona - një rrjedhë e përhershme e përvojës do të pëshpëritë përmes muresh. Mos lëviz. Dhe deti është këtu. Është buzëqeshja e një loje fëmijësh, përralla e harruar në pyje. Diçka po ndodh përmes gjetshes. Dhe po konturon fytyrën tënde - Ashtu siç s'e ke parë kurrë më parë.

Ende e kam frikë emrin tënd - Megjithëse dhimbja tashmë është larg, hije e padepërtueshme, dridhem i frikësohem linjave që bëjnë rastësisht, pa dashje, në vendet e shënuara që më ngjisin mbi humnera, ngrica, gjëra që i mbështolla me rezerva të bollshme intimiteti. Një tjetër idiomë u krijua, lidhje të reja, thuajse pa teprica, vazhdoj i them vetes - veçse mund të më zë pritë, edhe në momentet më shumë vigjilente, dridhem, shenja të së shkuarës që zhyten gjithnjë e më shumë në ertërsirë - Dhe unë të them, me heshtje mashtruese, pa më ndryshuar rrahjet e zemrës - që unë, fal.

*Përkthet: **Silvana Leka**

Opinion *i* Ditës

Katalonja spanjolle si Flandra Belge

Nga Dr. Jorgji KOTE

... së pavarësisë së Flandrës nga parlamenti i këtij rajoni në veri të Belgjikës më 13 dhjetor 2006. Ashu si në Katalonjë, këto ditë edhe në Flandër forcat dhe mbështetësit e pavarësisë së kësaj pjese të federatës belge, me gjithë acarën e dhjetorit festonin me eufori, parada, muzikë dhe fishekzjarrë. Kushdo që kalonte në Bruksel dhe qytete të tjera ato javë e më vonë, mund të shihte të valëviteshin flamujt e Flandrës në shumë dritare dhe ballkone shtëpish.

Ndërkohë, ngritja e flamurit të pavarësisë së Flandrës ishte një traumë e vërtetë për popullsinë e rajonit të Valonisë në jug të vendit dhe në Bruksel, por edhe për një shumicë të madhe në Flandër; tregojnë se tramvaji i linjës pasi mbërriti në stacionin Teruren në Bruksel, ndaloi dhe pasagjerëve iu kërkua të zbrisnin, sepse aty demokracia ishte kufiri me shtetin e ri të pavarur. Dhe më i madh ishte tensioni në politikën belge dhe atë evropiane.

E megjithatë, ato ditë dhjetori 2006, në Barcelonë dhe gjetë katalanasit shijonin të pasqetësuar kafën dhe diellin mëngjesor; duke e përcjellë me indiferencë këtë lajm dhe ngjarje tronditëse; ata po tregoheshin të urtë dhe të mençur, duke mos dhënë asnjë shenjë se do të ndiqnin shembullin flamand.

Tani e njëjta pamje vërehet në Belgjikë dhe në rajonin e Flandrës, që po i përcjellin ngjarjet dhe zhvillimet në Spanjë/Katalonjë me të njëjtën qetësi, heshtje dhe indiferencë. Natyrisht, jo si "hakmarrje", por për shkak të dinamikës antiseparatiste të ngjarjeve në Flandër, në Belgjikë dhe në botë gjatë 11 viteve të fundit.

E përmendëm këtë "invers" independentist, sepse nëse ka një rajon të ngjashëm pothuajse në të gjitha aspektet, historike, gjeografike, demografike, politike, ekonomike dhe me prirje të ngjashme separatiste me Katalonjën, ai është Flandra në veri të Belgjikës. Të dyja kanë parlamentin dhe qeverinë e tyre, edhe pse Flandra është pjesë e një shteti federal si Belgjika. Vërtet Katalonja me 32.000 km katrorë është 2,5 herë më e madhe në sipërfaqe, por gjithsesi ajo përfaqëson vetëm 10 për qind të territorit të Spanjës, ndërsa Flandra me 13.5 mijë km katrorë përfaqëson 45 për qind të territorit belg dhe me 6,5 milionë banorë përfaqëson mbi gjysmën e popullsisë belge, kurse Katalonja me 7,5 milionë banorë është vetëm sa 15 për qind të popullsisë së Spanjës.

Ashu si Katalonja, Flandra është rajoni më i pasur dhe më i zhvilluar industrial, bujqësor, tregtar dhe kulturor i Belgjikës. Edhe GDP-ja e tyre në përgjithësi dhe për frymë është pothuajse e barabartë. Ndërkohë, Flandra ka avantazhe kundrejt Katalonjës si nyje e madhe e trafikut të shumëllojshëm ndërkombëtar të transportit dhe shërbimeve. Porti i An-



versës është i dyti më i madh në Evropë, pas atij të Roterdamit, ndërsa tregu i Diamantit aty është më i madh në botë, me 10 për qind të eksporteve belge. Flandra ka genë dhe mbetet qendër e njohur e merkantilizmit ndërkombëtar, që lulëzoi në shekullin e XVII e kështu me radhë. Aty ndodhet veç të tjerash, Universiteti Katolik i Leuvenit, më i lashti në Evropë, i themeluar qysh në vitin 1425.

Kësisoj, Flandra dhe Belgjika bashkë me mënyrat dhe alternativat si e kanë trajtuar dhe po e zgjidhin në mënyrë demokratike, kushtetuese dhe në pajtim me frymën evropiane çështjen delikate të pavarësisë së saj, përfshirë dhe tensionet jo të pakta mund të shërbejnë si model për trajtimin e krizës së tanishme në Spanjë, pavarësisht krizës së tanishme.

Siç u përmend qysh në fillim, shpallja e pavarësisë së Flandrës më 2006 e futi Belgjikën në një spirale krizash qeveritare dhe institucionale, që u zgjidhën përfundimisht me negociatën të gjata në tetor 2011. Gjendja u stabilizua edhe më shumë pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2014, pas hyrjes për herë të parë Parlamentin Federal të partisë nacionaliste me prirje separatiste N-VA. Madje, falë një kompromisi vërtet historik përmes shumë debatare dhe kundërshtive të opozitës, N-VA hyri për herë të parë edhe në kabinetin e ri qeveritar federal me shumë poste kyçe si të ato të brendshëm, drejtësisë, financave,

etj. Kjo u bë mbi bazën e premtimit politik të liderit të saj se të paktën deri në zgjedhjet e vitit 2019, ajo nuk do t'i referohej aspiratës së saj për pavarësi, që në fakt ajo i është përmbajtur. Ishte ky një mesazh i fuqishëm se nacionalistët flamandë po hiqnin dorë gradualisht "dhe me lezet" nga synimi i saj strategjik për krijimin e Flandrës së pavarur.

Gjatë këtyre viteve në pushtet, lideri i saj karizmatik, Bart De Wever mbi bazën e zhvillimeve të reja politike, ekonomike e sociale në vend, kriza e azilit dhe ajo e terrorizmit si dhe analizave/studimeve të kryera nga ekspertët dhe politikanët të njohur mbi kostot dhe përfitimet përkatëse kuptuan më së miri se projekti flamand i ndarjes nuk do të ishte i realizueshëm e ca më pak të ishte i suksesshëm si brenda vendit e aq më tepër të njëjti në arenën ndërkombëtare. Sepse në radhë të parë, ende dhe sot mungon fryma separatiste, mungon mbështetja masive nga shumica e vetë Flandrës, sidomos rinia, biznesi, etj. Sipas të dhënave më të fundit, 75 për qind e banorëve të Flandrës pothuajse të gjithë janë flamandë, ata ndihen krenarë edhe si belgë dhe evropianë. Së dyti, pengesa madhore është statusi i trefishtë i Brukselit, si kryeqyteti i Valonisë, Belgjikës dhe BE-së dhe së treti, trashëgimia e borxheve kolosale në nivelin 105 për qind që do të kompromentonin rëndë idenë e pavarësisë me një kosto të tillë të papërbalueshme.

Tashmë është pothuajse e pamundur të mos përmendim se pavarë-

ësia e Flandrës nuk do të hidhet politik të liderit të saj se të paktën deri në zgjedhjet e vitit 2019. Në vend të saj, debatet dhe alternativat do të përqendrohen në zbatimin e mëtejshëm dhe vijimin e reformave institucionale, ripërtëritjen ekonomike dhe sociale të vendit, integrimin e të huajve, etj.

Ja pse Katalonja dhe Spanja mund të mësojnë nga Flandra dhe Belgjika në shumë drejtime. Edhe Belgjika është ndër shtetet tipike federale me 6 parlamente dhe qeveri rajonale, mijëra bashki dhe komuna, si dhe qeverinë e parlamentin federal dhe senatin. Një labirint i ngatërruar dhe gjatë organizimash, por që me gjithë problemet e pamohueshme, në përgjithësi funksionon kënaqshëm dhe sipas parimeve demokratikë evropianë.

Vlerë tjetër e madhe e këtij vendi federal është bashkëjetesa mjaft e mirë në kushtet e një diversiteti të pasqetësuar dhe kontrasteve jo pa probleme, që vështrirë se gjenden në vende të tjera dhe në Spanjë; janë kontraste të shumëllojshme - kështu, veriu banohet nga flamandë, ndërsa jugu nga valonë; veriu nga protestantë, jugu nga katolikë; në veri është në pushtet e djathta, në jug e majta; industria dhe tregtia janë në veri, bujqësia në jug, në veri flitet gjuha flamande, në jug ajo valone. Katalonja mund të mësojë gjithashtu nga Flandra se nuk është më koha e fragmentizimit dhe rajonalizimit, por e bashkimit, globalizimit dhe evropianizimit. Praktikisht, nëse

edhe rajonet të tjera në Evropë do të ndiqnin shembullin katalanas, atëherë siç pohoi para disa ditësh presidenti i Komisionit Evropian Jean Claude Juncker, BE-ja do të detyrohej të kishte 98 vende anëtare! Kjo do ta bënte krejt të pamundur funksionimin e saj.

Në këto kushte, alternativa më eftikase dhe e pranueshme për të gjithë është shtimi në maksimum i kompetencave të pushtetit lokal deri në nivel komune në të gjitha fushat, përfshi edhe atë të diplomacisë dhe politikës së jashtme, taksat dhe tatimet, etj. Tashmë në Belgjikë qeveritë rajonale kanë të drejtë të plotë të nënshkruajnë edhe marrëveshje ndërkombëtare, pa marrë pëlqimin e qendrës, me përjashtim të ndonjë marrëveshjeje me karakter federal dhe politik.

Mësimi tjetër i dobishëm është se probleme të kësaj natyre nuk zgjidhen me referendume/ultimatume, as me gjuhën apo përdorimin e forcës, edhe kur kjo justifikohet me kushtetutshmerinë. Këto të fundit në fakt më shumë u japin "municion" forcave nacionaliste se sa zgjidhin problem në fjalë, sepse atje votohet jo "me mendje, por me zemër". Referendumi për Brexit është rasti më i freskët dhe bindës në këtë drejtim.

Përfundimi i fundit dhe më i rëndësishëm që jep përvoja flamande/belge është se kriza dhe probleme të kësaj natyre zgjidhen në mënyrë të qëndrueshme vetëm ose kryesisht me dialog, bisedim, lëshime, tolerancë dhe kompromis ndërmjet të gjitha forcave politike dhe qeveritare, organizatave shtetërore dhe OJQ-ve, biznesit, organizatave ndërkombëtare dhe padyshim legjislacionit përkatës.

Mirëpo kjo kërkon përgjegjësimëri të lartë dhe nga lideri spanjoll në nivel kombëtar dhe atë rajonal. Pa përjashtuar mungesën e impenjimit të duhur politik më të hershëm dhe tërësor për trajtimin e kësaj krize të rëndë politike dhe institucionale nga qeveria spanjolle, shumica dërmuese e analistëve dhe ekspertëve politikë nënvizojnë misionin politik të liderit të Katalonjës, Puigdemont, që i ka hyrë një rrugë pa krye. Siç shprehet shkrintari i njohur belg, Grigoire Polet, ky muaj dhe java e fundit ishte irracionale për Katalonjën. Aty nuk pati "politikë, por mistikë". Kjo dëshmoi edhe njëherë se forcat nacionaliste/sep-aratiste mund të kenë vërtetë politikanë, por jo politika, ca më pak të qëndrueshme dhe të pranueshme nga komuniteti ndërkombëtar.

Ndaj, "Republika e Katalonjës" mund të thuhet se "ka lindur e vdekur". Në vend të saj, Spanja dhe Katalonja me siguri janë "të dënuara" t'i hyjnë një rrugë të gjatë përpjeksh dhe demashesh; vetëm me një "smart power" (fuqi të mençur) efektiv mund të gjenden zgjidhjet e duhura evropiane si "në frymë", ashtu edhe në "gërmë".

Dje në "Deutsche Welle"

Evropa ime: Corrida, Katalonja dhe pavarësia

Nga Stanislaw Strasburger

... rajonale. Është një e diel pasdite me diell, dita e parë e tetorit. Në një kohë që në Katalonjë zhvillohet referendumi i rrëmujshëm, unë rri ulur në arenën e demave të qytetit në Granadë. Para meje një festë e një natyre të veçantë, një përfundim shkollë. Një grusht nxënësish të veshur me rroba shumëngjyrëshe ka mbaruar shkollimin. Tani ata duan të tregojnë më në fund atë që kanë mësuar: vrasjen e demave të plagosur dhe të orientuar. Goya, Hemingway, Picasso - të gjithë ata genë të mrekulluar nga Corrida. Ndeshja e demave sipas tyre ishte një metaforë e artit, madje e vetë jetës. Por banorët e sotëm të Katalonjës e shohin këtë ndryshe. Në vitin 2010 parlamenti i Komunitetit Autonom të Katalonjës e ndaloi ndeshjen e demave. Gjashtë vjet më vonë, Gjykata Kushtetuese spanjolle e shpalli të paligjshëm këtë ndalim. Gjykatësit u bashkuam me interpretimin e qeverisë qendrore në Madrid, e cila e përcaktonte ndeshjen e demave si trashëgimi kulturor nacional (patrimonio cultural). Ky vendim erdhi pa prituri, në bazë të statistikave të portalit të lajmeve "Eldiario", vetëm një ndër dhjetë qytetarë të Spanjës ka qenë ndonjë herë në një ndeshje demash.

TUTELË NGA QEVERIA QENDRORE

Kur u largova nga arena, ndieja një përzierje zemërimi dhe hutimi. Dhe pyeta veten: çfarë u mbetejtë banorëve të Katalonjës, veç heqjes dorë nga Patrimonio së bashku me nacionalitetin spanjoll dhe ndërrimin e tij me ata katalanas? Ndeshja për Corridan është një shembull domethënës se si mund të shndërrohen iniciativat e rëndësishme për njerëzit të një rajoni të caktuar në një tutelë zhgënjyese nga politika nacionale. Katalonja u përball vitet e kaluara me një sërë përjetimesh të tilla kolektive. Kështu, katalanët i detruan që interesat e tyre të justifikoheshin në një gjuhë nacionale, sepse gjuha e vetëvendosjes autonome atyre i ndalua. Fjalimi televiziv i Mariano Rajoyt në ditën e referendumi në Katalonjë u përshat qartësisht me këtë model. "Ju flas si kryeministër i qeverisë së Spanjës - tha ai. - Spanja është një komb i madh, njëri prej më të vjetërve të Evropës dhe njëri prej kombeve të zhvilluara më mirë në botë (...), është kombi ynë". Sikur kjo të mos ishte e mjaftueshme, kryeministri i pështryn shprehimisht në fyturë njerëzit, të cilët kishin formuar radhë të gjatë ditën e votimit para zyrrave të dhënies së votës. "Një referendum nuk ka ekzistuar fare", tha Rajoy.

KLISHE QË LËNDONJË KUDO

Por edhe pala tjetër ka faj. Disa



ditë më vonë flas me një mësues në Granadë. "Nuk kam qenë kurrë nacionalist - më dha ai siguri, - por nuk mund ta pranoj, që si anduluzian që jam, të më damkosin si dembel, i cili gjoja ngrohet tërë ditën në diell dhe pi paratë e Katalonjës". Ajo me të cilën ndeshesh rregullisht është e njëjta pamje, e cila shpërndahet nga nacionalistët nëpër kontinent: "Ne jemi një komb i fortë, i fuqishëm. Ne duam të distancohemi nga më të varfrit, nga ata që kanë marrë arratinë, shkurt nga gjithë "të tjerët", pra prej atyre, të cilët duan të marrin me dredhi pasurinë për të cilën kemi punuar ne". Andaluzia është simboli i kurbanit për luftëtarët katalanas të pavarësisë, për Independencias-it. Është fakti i njohur që para nga rajonet më të fuqishme

ekonomikisht të Spanjës transferohen në jugun "me strukturë më të dobët" të vendit. "Nuk ishim ne që e zgjodhëm strukturën, bujqësinë tonë", shpjegon bashkëbiseduesi im, mësuesi. Ai më tregon për luftën e gjatë e me traditë të fshatarëve të Andaluzisë me pronarët e mëdhenj të tokave ose me korrupsionin. "Neve nuk na duan para nga Katalonja. As nga BE. Neve na duhet një reformë agrare".

NJË PAVARËSI FIKTIVE

Sa e gënjeshtërt mund të jetë tabloja e fuqisë ekonomike, këtë e tregon largimi i sipërmarrjeve nga Katalonja që prej 1 tetorit. Janë shënuar më shumë se 1300 firma që e zhvendosën selinë e tyre. Midis tyre janë edhe banka të mëdha, sipërmarrje prodhimi

dhe shërbimesh. Tendanca në rritje. "Koncepti i pavarësisë ka sjellë shumë vuajtje në botë. Askush nuk është i pavarur. As një njeri, as një popull. Ne të gjithë jemi genie solidare", shkroi shkrimtari spanjishtfolës, Max Aub. Tingëllon banale, por ndoshta ia vlen ta përsëritësh: secili nga ne jeton në varësi, si individ, si pjesë e një grupi, në çdo strukturë sociale, pavarësisht nga fakti si kalojnë kufijtë. Kështu që çdo pavarësi politike është relative. Këtë e dinë fare mirë politikanët. Po të pohojnë diçka tjetër, janë thjesht cinikë.

PËR NJË EVROPË MBINACIONALE

Çfarë i pengon në fakt politikanët e të dyja palëve që të nisnin negociatat për kushtet e solidaritetit që përmendëm? Katalonja nuk do të zhvendoset në Mars, por do të mbetet atje, ku është sot, midis Spanjës dhe Francës. Unë jam evropian i bindur. Katalonja dhe Corrida flasin për mua që çështjet e kulturës dhe të identitetit duhet të negociohen në plan rajonal. Pavarësia nacionale përkundrazi është një gënjeshtëri. Një Evropë mbinationale psh., si Republikë Evropiane do t'i mbannte më në fund parasysht si duhet këto fakte dhe do të jetë në gjendje që t'u ofrojë qytetarëve të kontinentit tonë forma të përshtatshme të vetëvendosjes. Stanislaw Strasburger ka lindur në Varshavë. Ai jeton në Berlin e Varshavë. Ai është shkrimtar dhe menaxher kulture. Vepra të tij janë "Fiksimi Liban" dhe "Tregtari i historive".

HOROSKOPI

DASHI

Me Plutonin që ndikon, sjellja ju e duhur mund të konsolidohet në vend që të jetë diçka e rastit. Pyesni veten, nëse e dini si do të reagojnë partneri. Mos u përzieni me gjëra që nuk ju takojnë dhe në lidhje me këtë bëni një sqarim.

DEMI

Me Uranin që grindet me Hënën, do të ishte mirë të mos dilni në konkluzione të menjëhershme për ato që do t'ju thonë. Dëgjojeni argumentet e të tjerëve, edhe pse brenda jush keni një ndjenjë të fortë rebelimi, që ju shtyn t'ju kundërviheni.

BINJAKET

Do të mbronni me kokëfortësi qetësinë me partnerin. Me pak fjalë do të jeni edhe më të bashkuar se më parë. Mos jini koprrac kur vjen puna për treguar dashurinë tuaj. Njerëzit që ju rrinë në krah, e meritojnë plotësisht.

GAFORJA

Me favorizimin e Jupiterit, nëse jeni në kërkim të një pune, dijeni se fati mund t'ju trokasë në derë. Mos rrii duarkryq. Falë Venusit mik, mund të hapni një kapitull të ri në dashurinë me personin e zemrës.

LUANI

Me Venusin, Marsin dhe Uranin kundër paralajmërohet një ngritje të menjëhershme tensionesh, si dhe ndonjë vendim që mund të merret në mënyrë të pakontrolluar. Nguiliteni mirë në mendje se gjaknxehtësia dhe paragjykimet mund të ndikojnë që të bëni më shumë se një gabim.

VIrgjeresha

Hëna pozicionohet me Venusin dhe Marsin. Do të keni fërkime me një familjar që këmbëngul që gjithçka shkon mirë, ndërsa në realitet ka tensione të fshehura. Kush jeton në çift, duhet të bëjë kujdes që të mos ndërlikojë atë që është e thjeshtë dhe e drejtpërdrejtë.

PESHORJA

Do të jeni nismëtar në këtë ditë bukur, i iniciativave të bukura në grup. Do të arëtoheni jashtë mase, duke harruar çdo shqetësim. Atëherë juaj për të dëgjuar kërkesat e partnerit dhe t'i plotësoni dëshirat do ta forcojë lidhjen.

AKREPI

Me ndikimin e Hënës, priten ulje dhe ngritje të humorit në lidhje me sqarime familjare, por jo përballje zënkash. Çlirohuni nga të tjerët. Veproni sipas mendjes suaj në çdo mjesdis, po u dashur fare t'u përshatjeni ritmeve të të tjerëve.

SHIGJETARI

Të jeni më të dashur ju bën të mirë. Padyshim do të lehtësoni ndjeshëm raportet me personin që keni në krah. Mos e harroni! Ndërhyrja e një familjari në punët tuaja do t'ju nervozojë disi, por nuk keni çfarë bëni.

BRICJAPI

Hëna nuk ka shumë gjëra për t'ju thënë. Nga ana tjetër, Merkuri dhe Venusi ju mbikëqyrin dhe i bëjnë gjërat më të thjeshta. Me mbështetjen e vyer të planetit të dashurisë, do të tejkaloni keqkuptime të rasti me partnerin.


UJORI

Një person ju tërheq së tepërmi e për rrjedhojë do të bëni në kurthin e dashurisë, duke u ushqyer me iluzione dhe ëndrra. Por ndërkaq e keni vetë në dorë nëse kjo dashuri do të materializohet. E rëndësime është të tregoheni në çdo cast vetvetja.

PESHQIT

Falë Jupiterit që ju mbështet, nëse keni ndonjë ide të bukur që ju shkon ndërmend, vëreni në veprim. Do t'ia dilni të gjeni edhe aleatë. Nëse do të ketë fërkime brenda familjes, shmanguni duke e kaluar me sportivitet.

Fjalëkryqi (1)



- 40. Një Madame e Maupassant.
- 41. Kështu thirrej Ernesto Guevara.
- 42. Fund ditari.
- 43. Pije piratesh.
- 45. Kush e thotë refuzon.
- 46. Të parat në sondazh.
- 47. Një makinë franceze.
- 48. Fillojnë stafetën.
- 49. Nisin nga fillimi.
- 50. Qant të Turandot.
- 51. Fundi i një samurai.
- 52. Umberto që shkroi Lavjeresi i Foucault.
- 53. Dalë në krye.

- VERTIKAL**
- 1. Ajo e tretë u quajt Moskë.
 - 2. Në hyrje të odës.
 - 3. Me mea për të pënduarin.
 - 4. Para... Gay në aeroplanin që hodhi bombën atomike në Hiroshimë.
 - 5. Jepet për hartim.
 - 7. Lindi edhe Cerberin.
 - 8. Mbyllin pora.


HORIZONTAL

- 1. Steiger aktor.
- 4. Mbetet në fund.
- 6. Ustinov i kinemasë.
- 11. Janë në modë.
- 12. Nuk e shqyen Danielin.
- 15. Një as i Milan.
- 16. Çobani aktore e jona.
- 18. I dyti në kapitull.
- 19. Dy asat në dorë.
- 21. Qe njeriu i parë që u dënua padrejtësisht.
- 23. Croft e Angelina Jolie.
- 24. Një që mbahet për mondan.
- 25. Para De Janeiro-s.
- 27. Gjysmë tandem.
- 29. Kap ndryshe.
- 30. Gjysmë tatimi.
- 31. Union Stutendor Operativ.
- 33. Wallach aktor.
- 35. Pak spiunazh.
- 37. Ishin hipokritët e Jezu Krishtit.
- 38. Ai dhe ajo.

VERTIKAL

- 9. Gjysma e ekipit.
- 10. Një inkursion me mig.
- 12. Fillojnë lehtë.
- 13. Eshhtë tretës me zorrë.
- 14. Pak tematike.
- 17. Qe mbretit jetëgjatë i Pilos.
- 20. Eshhtë ndalim me pranga.
- 22. Shkroi Këngëtarja tullace.
- 23. Eshhtë pikë vaji.
- 26. Ndajnë shtetet.
- 28. Kush nuk ka... s'është njoftuar.
- 32. Poetja e Lesbos.
- 34. Kështu shprehet komisar Rex.
- 36. Fillojnë panikun.
- 38. Një liqen i kripur.
- 39. Inva soprano.
- 43. Inicialet e Altman.
- 44. Një fjalë për sipër.
- 46. Të parat në stadium.
- 47. Fillojnë turmin.
- 48. Në hyrje të sokakut.
- 49. Fillojnë nazet

Fjalëkryqi (2)




- HORIZONTAL**
- 3. Një pune... paguhet.
 - 6. Para Zeppelin në grupin e famshëm.
 - 8. Vincenzo, bomber te Roma.
 - 12. Kufijtë e pritjes.
 - 13. Një Arthur i Edgar Allan Poe.
 - 16. Demek s'ka kufij.
 - 18. Qe filozofi i shkollës eleatike.
 - 19. Nino, kompozitor i famshëm italian.
 - 21. Eshhtë ai që ka ngritur krye.
 - 23. Finlanda e... finlandezëve.
 - 25. Mbledh basketë separatistë.
 - 26. Inicialet e Prost.
 - 28. Shkroi Cocktail party.
 - 29. Titulli i Alex ferguson.
 - 30. Stile pa kufij.
 - 32. Ishin greket që nuk vinin kurrë.
 - 35. Unë dhe ti.

- 36. Hoxha që qe arbitër.
- 38. Eshhtë provë zjarr.
- 39. Majtas në fund.
- 41. Agjenci Ajrore Tiranë.
- 42. Eshhtë partia e Ariel Sharon.
- 43. Një mund të jetë çiklistik.
- 45. Të parat në sondazh.
- 46. E famshme ajo e psherëtimave.
- 47. Qendër ditore.
- 48. Një Baba përrallor.
- 49. Mund të jetë proteste.
- 50. Në fund të fundit.


VERTIKAL

- 1. Camille, indulgjenti që krijoi Vieux Cordonier.
- 2. Në krye të solistëve.
- 3. Janë poetë si Ungaretti.
- 4. Ylli më i shndritshëm i Demit.




- 5. Janë kopjet si delja Dolly.
- 7. Një pjesë e dimensioneve.
- 8. Fillojnë muzikën.
- 9. Parafjala e prejardhjes.
- 10. Fernando, bomber i Liverpool.
- 11. Bisha aktore.
- 12. Ishin ushtarë të Kserksit.
- 14. Partia Demokratike.
- 15. Cepat e një ylli.
- 17. Ylli i baletit.
- 20. Pak amoralitet.
- 22. Mbushin enë pa fund në ferrin dantesk.
- 24. Italia në Internet.
- 27. Përhapet me frikë.
- 31. Mund të jetë françeskan.
- 33. Dehin pa kufij.
- 34. Eshhtë lënda për... raftë.
- 37. Gjysmë sahati.
- 39. Tatum që qe pianist.
- 40. Lloj papagalli.
- 42. Një pikë vaji.
- 44. Artikull spanjoll.
- 45. Në krye të socialistëve.

Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

	8		2		3		6	
5				9				7
		4	8		7	2		
9		5				4		8
	3						5	
1		2				9		3
		7	9		6	1		
2				7				5
	1		4		5		2	

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

9	6	4	3	2	7	8	1	5
5	7	3	8	1	4	9	2	6
2	1	8	9	5	6	4	3	7
1	8	2	6	4	3	7	5	9
6	4	7	1	9	5	3	8	2
3	5	9	2	7	8	6	4	1
7	2	1	4	8	9	5	6	3
4	9	6	5	3	2	1	7	8
8	3	5	7	6	1	2	9	4

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik

- "Vetëm nëse dikush është i verbër i sheh të gjitha ditët të njëjta. Çdo ditë është ndryshe. Çdo ditë sjell me vete një mrekulli të saj. Çështja është a mund ta dallosh atë". **Paulo Coelho**
- "Përpjekja e vazhdueshme për t'u pëllqyer të tjerëve, vret personalitetin tonë të vërtetë". **Konfuci**
- "Përpara se të nishet për hakmarrje, gërmo dy varre". **Konfuci**

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

5	E	P	O	U	S		10	8	13	
4	5	3	5			19	2	4	6	2
5	13	6		3	5	11	6	7	3	5
11	5		12	2	8	6	3	20	13	13
9		10	6	20	4	2		4	5	7
5	2		13	13	2	12	2		3	1
	12	13	10	2	3	5			6	11
2	7		5	1		3		3	12	8
19	2	4	3	6	6	6	4	2	11	6
2	13	3		5	10	6	13	2		9
4	1	8	5	3		12	5	11	9	5
6	11	2	7		8	2		6	11	4

T	F	S	T	O	P	K	P
F	I	E	R	H	A	R	P
O	F	E	K	A	S	A	I
K	O	F	A	N	A	T	I
A	F	E	N	O	M	E	N
K	A	R	A	M	E	L	E
K	N	A	D	A	R	R	O
O	I	T	A	L	I	A	R
F	A	E	I	K	O	N	A
I	R	T	O	T	A	L	I
N	A	F	D	E	N	S	H
I	T	E	R	E	D	E	A

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

ERASMI PAKETA
LORIS KUMARI
UNIK SAN P
AME SIMORE S
RHEMEREMETIMET
DELIKATE VILA
SARAFET RACER
PIRATI MOLINE
MIGENAJ RENAT
BESERETETI KRA
NAR KRITETEMA

FJALËKRYQI (2)

PAZAR KABINET
IRON MBETIM Z
TMEKETETRIO
TARTARTONION
TMTITANETANA
KASAMARITANE
ELIMANEDES
SOLANAKTECE
TUBORGUREROS
ODSAAKRENTA
KANSENARAHET
ENDEKATEETI



Ehënie të mençura

- Më mirë të jesh endacak e të udhëtosh vetëm, sesa të mykesh në shoqëri e budallenje.
- Lëviz nëpër botë duke festuar, kërcyer, kënduar, si një bletë; shko nga lulla në lule, vetëm duke provuar të gjitha eksperiencat, piqesh.
- Te jesh gjithmonë i ndershëm me veten, është një ushtrim i këndshëm. (Sigmund Freud)
- Vlera e një njeriu duhet parë në faktin se çfarë jep, dhe jo në atë se çfarë është në gjendje të marrë. (Albert Anjshajn)

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE



Tashmë edhe lundroni!

